

UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY FACULTY



FAKULTETI JURIDIK
ПРАВЕН ФАКУЛТЕТ
OF LAW

FAKULTETI JURIDIK
STUDIMET PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

TEZA E MASTERIT:

**“VRASJET E KUALIFIKUARA NË RRETHIN E
GJYKATËS THEMELORE NË GOSTIVAR NGA
VITI 2010-2018”**

KANDIDATI:

Arbnora Bajrami

MENTORI:

Prof.dr. Ismail Zejneli

TETOVË, 2020

Parathënie

Fillimisht dua të theksoj që qëllimi i zgjedhjes së kësaj teme ka qenë se si mund të ndikojë në marrjen e masave parandaluese të një fenomeni kaq të rrezikshëm i cili e rrethon qytetin tonë. Pra, do të mundohem të jap një pasqyrë lidhur me vrasjet, kryesisht vrasjet e kualifikuara të cilat kryhen në qytetin e tonë.

Punimi paraqet një përmbledhje të të dhënave në një sferë shumë të rëndësishme siç është zgjidhja drejt veprave të rënda penale.

Kjo sferë përfshin vrasjet e kualifikuara dhe faktorët objektiv dhe subjektiv të cilët ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit në mjedisin shoqëror.

Rëndësia e këtij punimi konsiston në faktin se merren në analiz të dhëna relevante arkivore nga të cilat mund të konstatohet se disa prej tyre janë më prezente në rrethinën e Gostivarit.

Duke u mbështetur në këto arsyje kam vendosur të shkruaj temën e lartpërmendur me shpresën se përmes saj do të arrij të shpalos rezultate të dobishme në sferën shoqërore duke analizuar arritjet dhe të metat e procedurave të vrasjeve të rënda penale në rajonin e Gostivarit.

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është parandalimi i privimit i paramenduar i tjetrit nga jeta, i kryer në rrethana specifike rënduese, të përcaktuara me ligj, që e ngrenë shkallën e të padrejtës dhe të fajsisë të kryersit , për të cilat ligji paraqet dënim të rëndë (burgim të përjetshëm).

Përmes këtij punimi do të mundohem të jap pasqyrim të qartë të përgjegjësisë të shtetit në parandalimin e kriminalitetit , për marjen e masave aktive, për mbrojtjen dhe parandalimin e veprave penale të rënda .

Tema bosht e këtij punimi është pasqyrimi i disa vrasjeve të kualifikuara më të evidentuara në rrethin e Gjykatës Themelore të Gostivarit nga viti 2010-2018 .

Gjithashtu objektiv i këtij punimi është që të njoftohen dhe të ofrohen zgjidhje të mundshme për parandalimin e këtyre fenomeneve shoqërore.

Mirënjohje

Lënda e hulumtimit e këtij punimi është vrasja e kualifikuar, posaçërisht vrasjet e kualifikuara të paraqitura në rajonin e Gostivarit nga viti 2010-2018, në mënyrë më specifike do të analizohen shkaqet të cilat na shpien deri te këto vrasje. Kam kënaqësi të shpreh mirënjohjen time më të thellë për personat të cilët më kanë dhënë mbështetjen e tyre gjatë gjithë kohës që kam punuar në këtë studim. Mentorit tim Prof.Dr. Mr Ismail Zejneli, i takon falënderim më i veçantë për koordinim dhe udhëheqje profesionale të punës dhe finalizimit teorik të punimit. Njëkohësisht, falenderoj të gjithë ligjeruesit e Fakultetit Juridik për frymëzimin që më kanë dhënë dhe kanë bërë të mundshëm zhvillimin dhe rritjen time akademike. Asnjëherë nuk do të arrij të shpreh falenderimin tim ashtu siç e ndjej ndaj familjes sime për durimin , mirëkuptimin dhe përkrahjen në të gjitha fazat e studimit. Ky rrugëtim nuk do të ishte i mundur pa inkurajimin dhe mbështetjen e tyre.

Lektoroi:

Doc.dr.Luljeta Adili-Çeliku

PËRMBAJTJA

Parathënie.....	2
Abstrakt.....	3
Hyrje	7
Metodologjia e punimit.....	8
KAPITULLI I	9
Vështrim i përgjithshëm mbi vrasjen si vepër penale	9
1.1 Vrasja e kualifikuar.....	17
1.2 Vrasja në mënyrë mizore	20
1.3 Vrasja në mënyrë tinzare (dinake)	20
1.4 Vrasja me dashje, me çrast rrezikohet jeta e personave të tjerë.....	21
1.5 Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore	23
1.6 Vrasja me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale.....	24
1.7 Vrasja nga hakmarrja e paskrupullt	24
1.8 Vrasja nga motivet e ulta	25
1.9 Vrasja në bazë të porosisë.....	26
1.10 Vrasja e gruas shtatzënë.....	26
1.11 Vrasja nga motivet fisnike (Eutanazia).....	27
1.12 Vrasja nga pakujdesia	29
KAPITULLI II.....	30
2. FAKTORËT QË NDIKOJNË NË VEPRËN PENALE TË VRASJES.....	30
FAKTORËT OBJEKTIV (TË JASHTËM)	30
2.1 Varfëria	31
2.2 Papunësia	32
2.3 Migrimi i njerëzve.....	33
2.4 Kushtet e vështira të banimit.....	35
FAKTORËT SUBJEKTIV (TË BRENDSHËM)	35
2.5 Karakteri	36
2.6 Temperamenti	38
2.7 Intelejjenca	39
2.8 Emocionet	40

2.9 Motivet.....	41
2.10-PROFILI I KRYERËSVE TË VEPRAVE PENALE TË KUALIFIKUARA.....	42
2.10.1. Mosh.....	42
2.10.2. Gjinia.....	44
2.10.3. Profesioni dhe kriminaliteti.....	45
2.10.4. Arsimi	46
2.11. Recidivizmi	47
KAPITULLI III.....	49
3. DËNIMET NË BAZË TË TIPOLOGJISË SË VRASJEVE TË KUALIFIKUARA.....	49
3.1 Dënimet kryesore	49
3.2 Dënimi me burgim sipas Kodit penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut	58
3.3 Rregullat minimale standard të OKB-së për trajtimin e të burgosurve.....	59
KAPITULLI I IV	63
4.1 Analiza dhe krahasimi nga materialet statistikore	63
4.2 Lënda e marrë nga gjykata themelore e Gostivarit	68
PËRFUNDIM	73
LITERATURA	75

Hyrje

Me anë të këtij studimi do të mundohem të paraqesim një pasqyrë të ecurisë së luftës kundër vrasjeve të rënda, si dhe të parandalimit të kriminalitetit dhe përmirsimit të shoqërisë, ku çdo individ duhet të trajtohet si një qenie njerzore. Qëllimi i këtij punimi është parandalimi i privimit të paramenduar nga jeta i tjetrit i kryer në rrethana specifike rënduese, të përcaktuara me ligj, që e ngre shkallën e të padrejtës dhe të fajsisë së kryesit , për të cilat ligji paraqet dënim të rëndë (burgim të përjetshëm). Përmes këtij punimi do të mundohem të jap pasqyrim të qartë të përgjegjësisë së shtetit në parandalimin e kriminalitetit , për marjen e masave aktive, për mbrojtjen dhe parandalimin e veprave penale të rënda. Tema boshte e këtij punimi është pasqyrimi i disa vrasjeve të kualifikuara më të evidentuara në rrethin e Gjykatës Themelore të Gostivarit nga viti 2010-2018 .

Gjithashtu, objektiv i këtij punimi është që të njoftohen dhe të ofrohen zgjidhje të mundshme për parandalimin e këtyre fenomeneve shoqërore. Punimi paraqet një përmbledhje të të dhënave në një sferë shumë të rëndësishme siç është zgjidhja drejt veprave të rënda penale. Kjo sferë përfshin vrasjet e kualifikuara dhe faktorët objektiv dhe subjektiv të cilët ndikojnë në paraqitjen e kriminalitetit në mjedisin shoqëror. Duke u mbështetur në këto arsye kam vendosur të shkruaj temën e lartpërmendur me shpresën se përmes saj do të arrij të shpalos rezultate të dobishme në sferën shoqërore duke analizuar arritjet dhe të metat e procedurave të vrasjeve të rënda penale në rrajonin e Gostivarit.

Metodologjia e punimit

Metodologjia e këtij punimi do të bazohet në analizën e lëndëve të marra për studim dhe aplikimin e metodave komparative, shqyrtimin dhe përpunimin e të dhënave të grumbulluara.

- Mbledhja e të dhënave

Faza e parë e hulumtimit bazohet në grumbullimin e të dhënave arhivore, statistikore si dhe burrimet tjera me relevancë, si të dhënat e publikuara nga institucionet e shtetërore.

- Shqyrtimi i literaturës

Shqyrtimi i literaturës ekzistuese lidhur me temën e hulumtimit, përfshirë edhe hulumtimin e temave të mëparshme me përmbajtje të ngjajshme dhe hulumtime të ndryshme për nivelin e implementimit të rekomandimeve në legjislacionin penal.

- Analiza e të dhënave të grumbulluara dhe përpilimi i tezës së magjistraturës

Metodologjia e aplikuar për këtë punim do të sigurojë një analizë gjithpërfshirëse të lëndëve të rënda penale në rrethin e Gostivarit si dhe specifikat e tyre të evidentuara gjatë studimit të statistikave.

KAPITULLI I

Vështrim i përgjithshëm mbi vrasjen si vepër penale

Vepra penale është kategoria qendrore në sistemin e së drejtës penale. Ajo e legjitimon të drejtën e ndëshkimit dhe e përcakton hapësirën (fushën) e represionit penalo-juridik, kurse nga nocioni i tij nxirren edhe kategoritë tjera themelore: *përgjegjësia penale dhe dënimi*. Pra, vepra penale, kryerësi i veprës penale dhe sanksioni penal janë çështjet më kryesore që i trajton e drejta penale.¹

Vepra penale është akt negativ i njeriut dhe i dëmshëm për shoqërinë. Ajo më së shpeshti paraqitet si rezultat i konflikteve ndërmjet individëve dhe interesave të tyre, individëve dhe shoqërisë, si mospajtim ndërmjet dëshirave, nevojave dhe mundësisë për përmbushjen e tyre, përkatësisht si zgjidhje negative e ndonjë situate konflikti. Ajo më së shpeshti është akt i vetëdijshëm dhe i vullnetshëm, por mund të jetë edhe akt i pamatur, si dhe akt i projektimit të imagjinatës së sëmure, përkatësisht rezultat i çregullimit shpirtëror. Ajo legjitimon të drejtën e ndëshkimit, dhe përcakton gjerësinë e represionit penal-juridik, kurse nga nocioni i tij nxjerrën edhe kategoritë tjera themelore: *përgjegjësia penale dhe dënimi*. Kur flasim për veprën penale nga njëra anë flasim për tip ligjor jo të drejtës, por nga ana tjetër edhe si ndodhi reale kriminale, i cili për nga veçoritë përgjigjet në tipin formal, apstrakt të sjelljes së ndaluar.² Veprimi apo sjellja e caktuar e njeriut është një ndër elementet themelore të çdo vepre penale. Veprimi shprehet te veprat penale që kryhen me veprim dhe mosveprim, te veprat penale të kryera me dashje dhe nga pakujdesia, te tentativa apo vepra penale e kryer, etj.

Me termin *veprim* nënkuptojmë të gjitha sjelljet apo veprimet e njeriut që manifestohen në botën e jashtme dhe të cilat janë të përcaktuara me ligj si vepra penale. Veprimet që ndodhin në psikën dhe vullnetin e brendshëm të njeriut, siç janë mendimi, dëshira, vendimi dhe qëllimi për të kryer veprën penale, nuk mund të konsiderohen veprime në kuptimin penalo-juridik dhe nuk mund të ndëshkohen po që se ato nuk manifestohen në botën e jashtme. Për t'u konsideruar një veprim relevant në të drejtën penale, ai duhet të jetë i vullnetshëm. I vullnetshëm

¹ Kambovski.V&Zejneli.I, E drejta penale pjesa e përgjithshme, Tetove, 2018, fq-84

²Vllado Kambovski, E Drejta Penale pjesa e përgjithshme, 2010, fq 123.

konsiderohet ai veprim i cili është ndërmarrë dhe dirigjuar nga ana e personit të vetëdijshëm dhe në bazë të vullnetit të lirë. Sipas të drejtës penale nuk do të konsiderohen si veprim dhe nuk do të ndëshkohen sjelljet apo veprimet që ndërmerren apo shkaktohen pa vetëdije, rastësisht apo nën ndikimin e dhunës apo kanosjes, kurse personi vepron me vetëdije, për kundër vullnetit të tij, në rastin kur nën ndikimin e dhunës apo kanosjes detyrohet të ndërmarrë veprimin e caktuar. Sa i përket definimit formalo-material së pari potencon elementin ligjor të ndalimit të veprës, si prezumim kryesor për përcaktimin e sferës që nuk është e së të drejtës penalo-juridike. Vepra penale në pajtim me parimin e ligjshmërisë, është vetëm ajo sjellje që shprehimisht është e ndaluar me ligj! Sado qoftë një sjellje e dëmshme dhe sado paraqet shkelje të vlerave dhe të mirave mbetet në kornizat e sjelljes socialnegative përderisa nuk ngrihet në nivel të sjelljes së ndaluar me ligj, por nga ana tjetër, dimensionin material që përbëhet nga shkelje e të mirave juridike është ajo që nocioni formal i veprës penale e lidh me sistemin social të vlerave. Përveç shkeljes së ndalesës ligjore abstrakte, vepra penale nuk mund të vëzhgohet ndryshe si e drejtë jo reale, ndodhi e vërtetë që në mes raporteve ndërnjerëzore paraqitet si sjellje me të cilën sulmohet jeta, trupi, paqja, siguria, pasuria, dinjiteti personal dhe të mirat tjera individuale, apo funksionet e përbashkëta të jetës. Në rezymenë e këtyre ekspozive veprën penale në kuptimin formalo-material e definojmë si sjellje e njeriut që është shprehimisht e ndaluar me ligj për shkak të asaj që paraqet shkelje apo kërcënim të vlerave dhe të mirave individuale dhe shoqërore.³ Evolucionin e konceptit themelor i veprës penale nga përgjegjësia kolektive në atë individuale, dhe nga ajo objektive në atë subjektive, mposhti nocionin e ndonjëhershëm objektiv të veprës penale si sjellje e njeriut që paraqet shkelje të të mirave mbrojtëse në kuptimin objektiv, pa asnjëfarë elementi subjektiv të anës së kryerësit. Në të drejtën penale bashkëkohore mbisundon nocioni objektiv-subjektiv, sipas të cilit vepra penale është sjellje e ndaluar me ligj të kryerësit të fajshëm. Pranimi i nocionit objektiv-subjektiv është i përcaktuar nga disa postulate kriminalo-politike. Të dënohet vetëm ai veprim i ndaluar që mund të ngarkohet në fajin e kryerësit, domethënë, gjithashtu të vihet barrierë e patejkalueshme e së drejtës shtetërore për ndëshkim.

Në kuptimin objektiv-subjektiv veprën penale e definojmë si veprim i kryerësit të fajshëm, e përcaktuar me ligj si e kundërligjshme dhe ndëshkuese, si dhe në raport me personat e papërgjegjshëm apo fëmijëve si veprim që është tregues i gjendjes së posaçme të personit i cili

³Vllado Kambovski, E Drejta Penale pjesa e përgjithshme, 2010, fq 124.

imponon zbatim të masave të posaçme për mjekim, ndihmë apo mbikëqyrje.⁴ Sipas qasjes së ekspozuar formalo-materiale dhe objektivo-subjektive, strukturën e nocionit të veprës penale e përbëjnë këto elemente: veprimi, përcaktueshmëria me ligj, kundërligjshmëria, faji dhe dënueshmëria. Vepra penale është veprim, sjellje e njeriut. Ai është elementi i pakontestueshëm nga ana e të gjithë autorëve që japin ndonjë definim të këtij nocioni. Veprimi ka domethënien e elementit material, real në nocionin e veprës penale, bazë ndaj të cilës shëndërtohen elementet tjera të tij. Kodi penale si vepër penale mund ta parasheh, duke ndaluar apo duke urdhëruar vetëm sjellje të caktuar, për arsye se përkundrazi kur do të ndëshkon njeriun për arsye se është i tillë ashtu siç është, apo mendimet e tij që nuk manifestohen nëpërmjet sjelljes së tij, do të kishte qenë ligj për shfarosje të njerëzve, e jo kod penal. Vepër penale paraqet vetëm ajo sjellje që është e parashikuar me ligj si vepër penale. Kuptimi i parimit të ligjshmërisë si parim themelor i së drejtës penale bashkëkohore përbëhet pikërisht nga kërkesa që ligji në mënyrë precize t'i caktojë kufijtë në mes të sjelljeve ndëshkuese dhe jondëshkuese, duke e garantuar lirinë e individit nga njëra anë, dhe duke i sjellë nën grushtin e dënimit sjelljet që paraqesin shkelje të të mirave individuale dhe shoqërore nga ana tjetër. Përcaktueshmëria në ligj është element formal ligjor në nocionin e veprës penale, me të cilin fiksohet forma e përgjithshme e veprës dhe caktohen elementet e tij ligjore (përbërja ligjore, figura ligjore e veprës). Në përcaktimin e elementeve tjera të veprës penale mund të qaset edhe kur do të vërtetohet se sjellja njerëzore i përgjigjet fotografisë natyrore të veprës së caktuar, të formës së tij tipike, respektivisht i përfshinë veçoritë formale të figurës ligjore të veprës. Vepër penale është vetëm ajo sjellje e njeriut që paraqet realizim kundërligjor të figurës ligjore të veprës, respektivisht të fotografisë të asaj vepre e përcaktuar me ligj. Kundërligjshmëria është raport në mes veprimit konkret dhe tipit abstrakt të veprës penale, në të cilën bazohet vlerësimi se në rastin konkret ai veprim paraqet shkelje të normës penalo-juridike. Sipas nocionit objektivo-subjektiv, element tjetër është faji, përgjegjësia subjektive e kryerësit. Vepër penale është ajo çka është e paraparë në ligj dhe veprim kundërligjor, për të cilën kryerësi është fajtor. Faji është qortim që i referohet kryerësit për shkak të asaj se me sjelljen e vet i shkel normat penalo-juridike dhe me të ka shkaktuar cënim apo kërcënim të të mirave juridike në mbrojtjen e së cilës janë vënë ato. Në lidhje me veprën e kryerësit që nuk është i aftë për faj – personi i papërgjegjshëm apo i mitur, elementi i fajit është i zëvendësuar me nocionin e gjëndjes së rrezikshme të personit të papërgjegjshëm apo të lënies së

⁴Po aty, fq-125

edukimit të të miturit që e bazojnë vlerësimin se për mënjanimin apo përmirësimin e tyre janë të domosdoshme masa të sigurimit apo masa edukuese.⁵

Elementi i fundit është dënimi i veprës. Vepra penale është sjellje për të cilën është paraparë dënim që i shqiptohet kryerësit të fajshëm. Dënimi domethënë kërcënim me dënim, parashikimi i dënimit për sjelljen me të cilin shkelen normat penalo-juridike, meritë e dënimit të veprimit të kundërligjshëm apo të fajshëm. (nullum crimen sine poena). Parashikimi i dënimit është kriter më i sigurtë pas të cilit vepra penale dallohet nga sjelljet tjera kundërligjore (deliktet civile). Dënimi është sanksioni kryesor. Merita e dënimit nuk do të thotë se për çdo vepër të kryer patjetër të shqiptohet dënim. Tjetër është dënimi i paraparë, kurse tjetër sanksioni që do të zbatohet në rastin konkret. Kjo tezë pranon faktin se në të drejtën penale bashkëkohore është i pranuar sistemi pluralist i sanksioneve përveç dënimit, janë paraparë edhe sanksione tjera (masat e sigurimit, masat alternative, masat edukativo-përmirësuese), që shqiptohen kur për to janë plotësuar kushtet e caktuara me dispozitat e përgjithshme. Gjithashtu vepra penale ekziston edhe në rastet ekskluzive të lirimit nga dënimi (të parapara në Kodin Penal në n.42 dhe 43) apo mosndëshkimi i kryerësit të fajshëm kur merita e dënimit bie nën minimumin që imponon zbatim të dënimit efektiv (n.48, vepra e rëndësisë së vogël). Me këto elemente janë të caktuara prezumimet e përgjithshme juridike për ekzistimin e veprës penale. Ato duhet të fitohen në çdo vepër penale pavarësisht a bëhet fjalë për vrasje, vjedhje, spiunim, etj. Në figurat ligjore të veprave konkrete elementet e përgjithshme janë të zhvilluara në nivel më të ulët, me përcaktim të modaliteteve të ndryshme të anës objektive dhe subjektive të veprës, me përshkrim më të afërt të mënyrës, kohës, vendit të veprimit, llojit të pasojës, elementeve shtesë të fajit siç është motivi, qëllimi, etj. Të gjitha elementet e përgjithshme janë të lidhura reciprokisht në nocionin e vetëm të veprës penale, ashtu që çdo element i ardhshëm e paraqet të mëparshmin. Sistemi i elementeve të nocionit të veprës penale nuk guxon të inklinojë nga koncepti kryesor i funksioneve dhe parimeve të së drejtës penale. Sistemi domethënë pranim të ligjeve të caktuara logjike për raportet e brendshme në mes pjesëve përbërëse të tij, që ka të bëjë me ligjdhënësin i cili nuk mund të improvizojë me të gjithë nocionet e përmendura, duke vënë ato në një regullim kaotik, por poashtu ndaj gjykatës që nis nga sistemi ashtu i vënë gjatë interpretimit teleologjik të

⁵Vllado Kambovski, E Drejta Penale pjesa e përgjithshme, 2010, fq 126.

ligjit dhe zhvillimit të “teknologjisë” së vendosjes gjyqësore: gjykata vërteton ekzistimin e veprimit, e më pas përcaktueshmërinë në ligj etj.⁶

Funksioni mbrojtës i së drejtës penale drejtpërdrejtë implikon edhe objekt të caktuar të mbrojtjes së tillë, i përfshirë me nocionin e së mirës juridike! Sipas qasjes formalo – materiale, vepra penale është sjellje e njeriut që është e ndaluar me ligj për shkak të asaj se paraqet cënim apo kërcënim të vlerave dhe të mirave individuale dhe shoqërore. Në kuptimin formal, me të mirë juridike kuptohet ai interes, vlerë apo e mirë që drejtpërdrejtë mbrohet me normën penalo-juridike. Në kuptimin material, e mirë juridike është diçka çka i paraprijnë ndalesës penalo-juridike, që e motivon duke paraqitur kriter vlerësues të ligjdhënësit në vënien e tij. Vepra penale është kategori themelore në sistemin kategorial të së drejtës penale për arsye se në sistemin e elementeve të veprës penale, e mira juridike ka pozicionin e prezumimit bazik: Çdo vepër penale është drejtuar kundër vlerës apo interesit të caktuar që me përcaktueshmërinë e veprës në ligj fiton status i së mirës juridike.⁷ E mira juridike si objekt i veprës penale na intereson së pari nga aspekti i mbrojtjes penalo-juridike, ndryshe siç e quajmë edhe objekt i mbrojtjes. Objekt i mbrojtjes është nocion abstrakt, gjenerik, i cili e përfshinë idenë e të mirës juridike, vlerës apo interesit që mbrohet me inkriminimin konkret. Në teorinë juridike dallojnë dy lloje të subjekteve të veprës penale: subjekti aktiv dhe pasiv. Subjekt aktiv është kryerësi i veprës penale. Cilësia e kryerësit është imanente në veprimin si element material në nocionin e veprës penale, në çka referon edhe vet shprehja. Subjekt aktiv i veprës penale mund të jetë cilido person fizik i aftë që ndërmerr ndonjë veprim, pa marrë parasysh gjininë apo moshën.⁸ Subjekt pasiv është person që i është shkaktuar apo është lënduar me veprën penale, përkatësisht viktimja e veprës penale. Edhe pse nuk ekziston definim pozitiv-juridik për atë nocion, përshkrimet ligjore të veprës çdoherë nga shfaqja e qartë për të me çka përbëhet pasojja dhe të mirat e të cilëve shkelen me kryerjen e veprës! Kjo nuk vlen për veprat formale, figura e së cilës nuk inkadron veprimin e pasojës konkrete. Të ralla janë dispozitat ligjore që prej së afërmi përcaktojnë viktimën dhe cilësinë e saj. Ato janë vepra me viktimja sociale speciale siç është: maltretimi i të miturit, vrasja e gruas shtatzënë etj.⁹ Mënyrën ndërmjet të cilës manifestohet veprimi i kryerjes së veprës penale, në të drejtën penale njihen dy lloje të veprave penale: vepra penale të kryera me veprim

⁶Vllado Kambovski, E Drejta Penale pjesa e përgjithshme, , 2010, fq 127.

⁷Po aty, fq 128.

⁸Po aty, fq 129-130.

⁹Po aty, fq 135.

dhe me mosveprim. Veprat penale të kryera me veprim, në kuptimin penalo-juridik, veprimi është lëvizje trupore e vullnetshme e njeriut me të cilin kryhet vepra penale. Me anë të këtyre veprave ndryshe siç quhen delikte komiseve, çënohen normat penalo-juridike, të cilat e ndalojnë veprimin e caktuar. Veprat penale të kryera me mosveprim: apo siç quhen ndryshe delikte omisive kryhen me mos ndërmarrjen apo apstenimin nga veprimi që ka qenë i detyruar ta ndërmarrë. Kjo mënyrë e kryerjes së veprës penale shprehet si qëndrim pasiv i njeriut me rrethanat e caktuara, për shkak të cilit qëndrim shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme.¹⁰ Tani do të japim disa vështrime të përgjithshme në lidhje me veprat penale, kryesisht veprat penale kundër jetës të cilat janë më të rënda sepse ato çënojnë të drejtën për të jetuar si një e drejtë më e çmuar dhe themelore, e cila njëkohësisht është e garantuar edhe me kushtetutë edhe me aktet ndërkombëtare. Respekti ndaj jetës së njeriut dhe integritetit trupor paraqet bazën elementare të civilizimit tonë. Historia e njerëzimit edhe historia e luftës së njeriut për ekzistencën e tij fizike kundër vetëvetes (për dallim nga bota shtazore, në të cilën armik i njërit lloj është lloji tjetër, ndërkaq, armiku më i madh i njeriut është, siç thuhet, vetë njeriu). Sot nuk ekziston legjislacion penal që nuk u ofron mbrojtje këtyre të mirave themelore dhe më të vlefshme të njeriut. Vetëdija për karakterin e tyre universal është inkorporuar edhe në më shumë dokumente ndërkombëtare të rëndësisë fundamentale për liritë dhe të drejtat e njeriut si Deklarata Universale për të drejtat e njeriut e OKB-së e vitit 1948, neni 3, Pakti për të drejtat civile dhe politike, neni 6, ku thuhet: Çdo njeri ka të drejtën e lindur në jetë, që duhet të mbrohet me ligj, askush nuk mund në mënyrë arbitrare të privohet nga jeta. Pacënueshmëria e jetës dhe integritetit trupor të ne është ngritur në rang të parimit kushtetues, (neni 10 i Kushtetutës së RM-së).¹¹ Mbrojtja e jetës së njeriut ka karakter absolut, në kuptim që jeta mbrohet pa marrë parasysh ndjenjën për jetë, interesin jetësor të individit, pa marrë parasysh vlerësimin e jetës së individit nga ana e shoqërisë, edhe pa marrë parasysh atë se për cilën fazë të jetës bëhet fjalë. Megjithatë, ekzistojnë edhe disa përjashtime nga kërkesa për respektin absolut të jetës së njeriut, siç janë: lufta, dënimi me vdekje në disa legjislacione, vrasja në mbrojtje ekstreme, andaj del se respekti ndaj jetës biologjike të njeriut ka të bëjë me orientimet themelore sociologjike dhe antropologjike të shoqërisë, me çka mund të konstatohet se e drejta themelore e njeriut në jetë duron edhe disa kufizime të caktuara sociale. Veprat kundër jetës dhe trupit shprehen si një raport i caktuar

¹⁰ Ismet Salihu, E Drejta Penale pjesa e përgjithshme, 2012, fq 214-215.

¹¹ Ismail Zejneli, E Drejta Penale pjesa e posaçme, Tetovë, fq 17-18.

interpersonal midis kryerësit dhe viktimës, që më së shpeshti e merr trajtën e kontaktit të drejtpërdrejtë fizik. Në një numër të madh të rasteve në ngjarjen kriminale kontribut ka edhe vet objekti i sulmit, pra, viktimja. Presupozimi se te një numër i madh i veprave ekziston ndonjë kontribut i viktimës dhe se nga studimi i rolit të saj në kryerjen e veprës mund të rezultojnë njohuri të shumta me vlera teorike dhe praktike, ka sjellë deri te paraqitja e një disipline të veçantë në kuadër të kriminologjisë, pra, paraqitja e viktimologjisë, si shkencë mbi viktimën. Njeriu ka liri absolute të disponimit me jetën e vete dhe integritetin trupor: vetëvrasja nuk është vepër penale, gjithashtu vetëlëndimi, përveçse kur paraqet mënyrë të rrezikimit të të mirave tjera shoqërore (kështu te vepra e nenit 342 të KP-së –shmangia nga shërbimi ushtarak me pa aftësim). Liria e njeriut që të disponojë me këto të mira nuk përfshin edhe lirinë e tij që tjetrit t’ia barte autorizimin për të disponuar me to. Së këndejmi, nuk është përjashtuar kundërligjshmëria e vrasjes e kryer në bazë të kërkesës së viktimës, ose me shprehjen paraprake të pajtimit të viktimës. E njëjta vlen edhe për lëndimet trupore.¹²

1.Vrasja

Me vrasje nënkuptojmë atë vepër të kundërligjshme, me anë të së cilës i merret jeta një personi tjetër me dashje ose nga pakujdesia. Përveç veprës themelore të vrasjes ekzistojnë edhe vepra të kualifikuara dhe të privileguara të vrasjes, të cila nga vepra themelore dallohen me disa rethana shtesë, siç janë: mënyra e kryerjes, karakteristikat e viktimës, rrethanat subjektive dhe të ngjajshme. Objekti i mbrojtjes te të gjitha veprat e vrasjes është jeta e njeriut. Veprimi i kryerjes është përcaktuar nëpërmjet shkaktimit të pasojës: privimit nga jeta, dhe çdo veprim me të cilin shkaktohet vdekja e një personi. Pasoja qëndron në paraqitjen e vdekjes.Vepra konsiderohet se është përfunduar me momentin e paraqitjes së vdekjes.¹³Subjekti i veprës penale të vrasjes mund të jetë çdo person që ka mbushur moshën e caktuar me ligj për përgjegjësi penale. Vrasja mund të kryhet me dashje ose nga pakujdesia. Për veprën penale të vrasjes është paraparë dënim me burgim në kohëzgjatje prej së paku pesë vitesh. Forma e rënde e veprës penale të vrasjes është paraparë në paragrafin 2, dhe konsiderohet se është kryer në këto raste: nëse tjetri privohet nga jeta në mënyrë të paskrupullt, nëse tjetri privohet nga jeta me paramendim, nëse tjetri privohet nga jeta me porosi, nëse privohet nga jeta gruaja shtatzënë apo nëse privohet nga jeta personi

¹²Ismail Zejneli, E Drejta Penale pjesa e posaçme, Tetovë, fq 18.

¹³Po aty, fq 19.

zyrtar ose ushtarak gjatë kryerjes së detyrave të sigurimit publik në ruajtjen e rendit publik. Për këtë formë të veprës penale është paraparë dënim me burgim në kohëzgjatje prej së paku dhjetë vitesh ose dënim me burgim të përjetshëm.

Në bazë të nenit 123 të Kodit Penal të RM-së:

- (1) Ai i cili do ta privojë tjetrin nga jeta, do të dënohet më së paku 5 vjet burgim.
- (2) Më së paku dhjetë vjet burgim ose burgim të përjetshëm do të dënohet personi i cili:
 - 1) do të privojë tjetrin nga jeta në menyrë mizore apo tinëzare,
 - 2) do të privojë tjetrin nga jeta gjatë ushtrimit të dhunës familjare,
 - 3) do të privojë tjetrin nga jeta dhe pastaj me dashje do ta sjellë në rrezik edhe jetën e ndonjë personi tjetër,
 - 4) do të privojë tjetrin nga jeta nga levërdia, për të kryer ose mbuluar ndonjë vepër tjetër, nga urrejtja e panjerëzishme ose motive të ulta,
 - 5) do të privojë tjetrin nga jeta në bazë të porosisë,
 - 6) do të privojë tjetrin nga jeta për shkak të nxirrjes së organit, indit apo qelizës për mbjellje,
 - 7) do të privojë nga jeta femrën, të cilën e di që është shtatzënë ose person i mitur,
 - 8) do të privojë nga jeta gjykatësin, prokurorin publik ose avokatin, gjatë kryerjes së funksionit përkatësisht veprimtarisë së tyre, ose person zyrtarë ose ushtarak gjatë kryerjes së punëve të sigurisë publike, kapjes së kryerësit të veprës penale ose ruajtjes së personit të privuar nga liria.
- (3) Më së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm do të dënohet ai i cili me dashje do të privojë nga jeta dy ose më tepër persona, për të cilët nuk i është gjykuar më parë, vetëm nëse nuk bëhet fjalë për veprat penale nga neni 9, paragrafi 3, neni 10, paragrafi 3, si dhe nenet 124,125,127.¹⁴

¹⁴Kodi Penal i RM-së, 2015, fq 131.

1.1 Vrasja e kualifikuar

Nocioni dhe llojet

Vrasja e kualifikuar (e rënde) është privim i paramenduar i tjetrit nga jeta, i kryer në rrethana specifike rënduese, të përcaktuara me ligj, që e ngrenë shkallën e të padrejtës dhe të fajësisë të kryerësit, për të cilat ligji për këtë veprë parasheh dënim të rëndë (burgim të përjetshëm). Vrasja e kualifikuar dallohet nga vrasja e rëndomtë sipas rrethanave të caktuarakualifikuese të natyrës objektive dhe subjektive. Së këndejmi, mund të dallojmë më tepër grupe të rrethanave që vrasjes me paramendim i japin karakteristikën e ndonjërës nga vrasjet e rënda të përfshira në këtë dispozitë (përndryshe, karakterin e vrasjeve të kualifikuara e kanë edhe veprat tjera jashtë këtij kapitulli, si p.sh. ato të parapara në nenet 237,238 dhe 309 të KP të RM-së).

Në bazë të nenit 237 të Kodit Penal të RM-së

- (1) Ai që me përdorim të forcës apo të kërcënimit së drejtpërdrejtë do të sulmojë ndaj jetës apo trupit të tjetërkujt, do të marrë ndonjë send të huaj të luajtshëm me qëllim që ta përvetësojë në mënyrë të kundërligjshme, do të dënohet me së paku pesë vjet burgim.
- (2) Nëse vlera e sendit të marrë është me përmasa të mëdha, kryerësi do të ndëshkohet me së paku tetë vjet burgim.
- (3) Nëse vlera e sendit të marrë është më e vogël, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri pesë vjet.
- (4) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi (1) deri (3) të këtij neni ndonjë personit me paramendim i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor ose nëse vepra është kryer në përbërje të grupit, bandës apo nëse është përdorur armë zjarri apo mjet i rrezikshëm, ose nëse gjatë kryerjes së veprës në bankë, këmbimore, postë apo në vend publik, është kërcënuar jeta apo trupi i dy e më tepër personave, kryerësi do të dënohet më së paku me dhjetë vjet burgim.

- (5) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi (1) ndonjë personit me paramendim është privuar nga jeta, kryerësi do të dënohet më së paku dhjetë vjet burgim ose burgim të përjetshëm.¹⁵

Në bazë të nenit 238 te Kodit Penal të RM-së

- (1) Ai i cili është gjetur në vjedhje, do të përdorë forcë apo kërcënim të drejtpërdrejtë do të sulmojë ndaj jetës apo trupit të tjetërkujt me qëllim që ta mbajë sendin e vjedhur, do të dënohet me së paku pesë vjet burgim.
- (2) Nëse vlera e sendit të vjedhur është me përmasa të mëdha, kryerësi do të dënohet me së paku tetë vjet burgim.
- (3) Nëse vlera e sendit të marrë është më e vogël, kryerësi do të dënohet me burgim prej një deri pesë vjet.
- (4) Nëse gjatë kryerjes së veprës penale nga paragrafi (1) deri në (3) të këtij neni ndonjë personit me dashje i është shkaktuar lëndim trupor ose nëse vjedhja grabitqare është kryer në përbërje të grupit, bandës ose nëse është përdorur armë zjarri apo mjet i rrezikshëm, ose nëse gjatë kryerjes së veprës në bankë, këmbimore, postë apo në vend publik është rrezikuar jeta apo trupi i dy apo më tepër personave, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim.
- (5) Nëse gjatë kryerjes së veprës nga paragrafi (1) ndonjë personit me dashje është privuar nga jeta, kryerësi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.¹⁶

Në bazë të nenit 309 të Kodit Penal të RMV-së

Ai i cili me qëllim që ta rrezikojë rendin kushtetues apo sigurinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta privojë nga jeta Kryetarin e Republikës së Maqedonisë, e Kuvendit, e Qeverisë, e Gjykatës Kushtetuese ose e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së

¹⁵Kodi Penal i RM-së, 2015, fq 202.

¹⁶Kodi Penal i RM-së, 2015, fq 202.

Veriut, ose Prokurorin publik të Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose burgim të përjetshëm.¹⁷

Rrethanat që kanë të bëjnë me mënyrën e kryerjes janë: vrasja në mënyrë mizore, vrasja me vënien në rrezik të jetës dhe të ndonjë personi tjetër, ndërsa rrethanat që kanë të bëjnë me motivet e kryerësit janë: vrasja nga lakmia (fitim pasuror) për shkak të kryerjes ose fshehjes së veprës tjetër penale, vrasja nga hakmarrja (e vrazhdë), nga motivet tjera të ulta: si, vrasja në bazë të porosisë.

Rrethanat që kanë të bëjnë në karakteristikën dhe detyrimin e viktimës janë: vrasja e personit zyrtar ose ushtarak në kryerjen e detyrimeve të caktuara të sigurisë ose gjykatësit, prokurorit publikose ose avokatit gjatë ushtrimit të funksionit të tij. Ekzistimi i më shumë rrethanave kualifikuese është me rëndësi për matjen e dënimit.

Për vrasjet e kualifikuara është paraparë dënim me burgim në kohëzgjatje prej së paku dhjetë vitesh ose dënim me burgim të përjetshëm. Ky dënim zbatohet edhe për vrasjet e paramenduara të dy ose më shumë personave, për të cilat kryerësit paraprakisht nuk janë dënuar, përveç nëse nuk bëhet fjalë për vepra të kryera me tejkalimin e nevojës ekstreme ose për vrasje të privileguara (neni 123 paragrafi 3 I KP të RM-së).

Në bazë të nenit 123 të Kodit Penal të RMV-së

Paragrafi (3) Më së paku dhjetë vjet burgim ose me burgim të përjetshëm do të dënohet ai i cili me dashje do të privojnë nga jeta dy ose më tepër persona, për të cilët nuk i është gjykuar më parë, vetëm nëse nuk bëhet fjalë për veprat penale nga neni 9, paragrafi 3, neni 10, paragrafi 3, si dhe nenet 124,125,127.

Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet rrethanave, pasi ato janë elementi jetik që përcakton formën (llojin) e vrasjes. Vrasja e kryer në mënyrë mizore ose tinëzare dhe vrasja duke i dhënë jetë një personi tjetër, janë në kategorinë e vetëvrasjeve të kualifikuara. Një tipar i zakonshëm i vrasjeve të kualifikuara është se natyra juridike e vrasjeve të zakonshme është zgjeruar dhe elemente të caktuara kualifikuese i shtohen këtij rrethi të veçorive objektive dhe subjektive. Natyra e atyre elementeve kualifikuese është e tillë që vrasja e zakonshme të ngritet

¹⁷Po aty, fq 263.

në një shkallë më të lartë të padrejtësisë, e cila e shëndron këtë vrasje në një vrasje të vështirë, të kualifikuar të llojeve të ndryshme.¹⁸

1.2 Vrasja në mënyrë mizore

Vrasja në mënyrë mizore karakterizohet me shkallën enorme të mundimeve dhe vuajtjeve fizike të viktimës. Për ekzistimin e këtij lloji të vrasjes janë të nevojshme dy elemente të natyrës objektive dhe subjektive. Elementi objektiv shprehet në të shkaktuarit e mundimeve dhe dhimbjeve të mëdha ndaj viktimës, ndërkaq, elementi subjektiv në vetëdijen dhe dëshirën, përkatësisht pëlqimin e kryerësit që të shkaktohen mundime dhe dhimbje të tilla.¹⁹ Që të konsiderohet një vepër penale si vrasje mizore ajo duhet të jetë mizore në sytë e viktimës, e cila i përgjigjet dhimbjes dhe vuan gjatë gjithë kohës gjatë kryerjes së aktit të vrasjes. Duke pasur parasysh elementet e nevojshme për ekzistencën e mizorisë, pyetja është nëse vrasja është mizore kur vikzima është pa vetëdije dhe nuk ndjen dhimbjen e një mizori shtesë. Në këtë rast, ekspertet tregojnë se nuk ekziston vrasje mizore nëse viktima është e pavetëdishme dhe nuk ndjen dhimbje. Krimi i vrasjes në një mënyrë mizore ekziston kur i ndjeri pësn dhimbje të forta fizike, torturohet dhe vuan para vdekjes së tij, dhe i pandehuri me dashje kërkon të shkaktojë dhimbje të tilla ndaj tij, gjithashtu vrasja mizore kryhet kur kryerësi shkakton një numër të goditjeve dhe kur i ndjeri ndjente dhimbje dhe vuajtje të mëdha, të cilat i pandehuri ishte i vetëdijshëm dhe dëshironte ta bënte. Gjykatësit përpiqen të përcaktojnë se çfarë është kjo vrasje mizore, duke pasur parasysh shkallën e rritur të vuajtjeve fizike dhe vuajtjeve të viktimës, si dhe vetëdijen dhe gatishmërinë e kryerësit për t'i shkaktuar vuajtje të tilla viktimës.

1.3 Vrasja në mënyrë tinzare (dinake)

¹⁸Kodi Penal i RM-së, 2015, fq 131.

¹⁹ Ismail Zejneli, E Drejta Penale (pjesa e posaçme) Tetovë, fq 21.

Vrasja në mënyrë tinzare nënkupton privimin e personit nga jeta në mënyrë të fshehtë duke shfrytëzuar besimin dhe sinqeritetin e viktimës. Thënë ndryshe, vrasja në mënyrë dinake konsiderohet si e tillë kur kryhet në mënyrë të fshehtë dhe mashtruese. Si vrasje të tilla mund të përmenden vrasja në gjumë, dhe vrasja nëpërmjet helmimit. Në bazë të Kodit Penal neni 123 paragrafi (2) me së paku dhjetë vjet burg ose burgim të përjetsheëm do të dënohet personi i cili do të privojë tetrin nga jeta në mënyrë mizore apo tinzare. Kjo vrasje e kualifikuar karakterizohet me intenzitetin e saj më të lart. Ajo paraqet veprimin që në kuptimin objektiv dhe subjektiv i tejkalon suazat e fshehtësisë dhe dinakërisë të cilat rëndom shfaqen te vrasja me dashje. Nga ana objektive, te ky lloj i vrasjes kryerësi vepron në mënyrë të fshehtë, ndërsa në aspektin subjektiv kryerësi vepron në mënyrë tinzare (dinake) jo të sinqertë, mashtruese dhe me qëllim të keq dhe duke shfrytëzuar edhe besimin e viktimës që e ka ndaj tij.²⁰ Edhe këtu, tiparet objektive dhe subjektive i tejkalojnë suazat e fshehtësisë dhe dinakërisë, që shprehen te vrasjet me dashje. Mizoria dhe vrasja në mënyrë të fshehtë janë vendosur në një artikull, megjithatë janë dy lloje të ndryshme vrasjesh. Kjo vrasje e kualifikuar karakterizohet nga një intenzitet më i madh i veprimit të fshehtë dhe për të arritur fshehtësinë e viktimës me qëllim që ta privojë atë nga jeta me aq pak rezistencë sa shfrytëzuesi i saj shfrytëzon pafuqishmërinë dhe besimin. Objektivisht, kjo vrasje kryhet në mënyrë të heshtur dhe me fshehtësi nga ana e kryerësit i cili papritmas e privon nga jeta viktimën në kohën kur ai është i pafuqishëm dhe i pambrojtur, ndërsa subjektivisht kjo vepër konsiderohet një shprehje e sjelljes mashtruese dhe dinake, e abuzimit të besimit, joshës dhe heqjes së dyshimit për rrezikun e krijuar nga kjo situatë. Teoricientët thonë se, vrasja në pritje mund të konsiderohet si vrasje tinzare nëse kryerësi ka marrë disa veprime të mëparshme mashtruese për të joshur viktimën në pritje, pikërisht këtu vihet re pafuqia e viktimës. Për ekzistimin e një vrasje të kualifikuar nuk është e mjaftueshme personi që fle të jetë privuar nga jeta, megjithatë përveç kësaj kryerësi duhet të ketë vepruar mashtrime, të keqpërdorë shpresën, në një mënyrë të pandershme ose dashakeqëse, pafuqishmërinë ose besimin e viktimës.

1.4 Vrasja me dashje, me çrast rrezikohet jeta e personave të tjerë

Sipas KPM vepra penale është kryer me dashje kur kryerësi i veprës penale ka qenë i vetëdijshëm për veprën e tij dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj apo ka qenë i vetëdijshëm se për

²⁰ Ismail Zejneli, E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Tetovë, fq 21.

shkak të veprimit apo mosveprimit të tij, mund të shkaktohen pasojat e dëmshme,por është pajtuar me kryerjen e saj.²¹Ekzistojnë dy lloje vrasjeve me dashje: *direkte* dhe *indirekte*. Elemente të përbashkëta të dashjes direkte dhe eventuale janë *vetëdija për veprën dhe vullneti për kryerjen e saj*, te dashja direkte e përcaktuar si *dëshirë për kryerjen e veprës*, kurse te dashja eventuale si *pajtim me pasojën e saj*.Në bazë të atyre elementeve, dashja përcaktohet si ***kryerje e vetëdijshme dhe e dëshirueshme e veprës penale***.Në strukturën e nocionit të fajit, dashja është një ndër elementet nëpërmjet të cilit shprehet *raporti psikologjik* i kryerësit ndaj veprës së tij e njëherit edhe *substrati themelor psikologjik i fajit*.

Më së paku dhjetë vjet burgim ose burgim të përjetshëm do të dënohet personi i cili:

Do të privojë tjetrin nga jeta dhe pastaj me dashje do ta sjellë në rrezik edhe jetën e ndonjë personi tjetër. Për t'u konsideruar vepra si e tillë, është e nevojshme të krijohet rrezikshmëri konkrete.Vrasja e tillë ekziston atëherë kur bëhet fjalë për atë mënyrë të kryerjes, me të cilën kryerësi shkon, vepron ose pajtohet me kryerësin tjetër që ta vënë në rrezik jetën e ndonjë personi tjetër gjatë kryerjes së veprës penale vrasje. Për ekzistimin e kësaj vrasje të kualifikuar është e nevojshme të shkaktohet rreziku konkret për jetën së paku edhe të një personi tjetër, përveç viktimës . Ana subjektive te vepra kryhet me dashje e cila duhet të përmbajë edhe vetëdijen për rrezikimin e jetës dhe të personave tjerë. Vrasja e kualifikuar do të ekzistojë, kur gjatë kryerjes së vrasjes me dashje është privuar nga jeta edhe ndonjë person tjetër.Ky lloj i vrasjes mund të kryhet me dashje direkte apo me dashje eventuale. Qënia objektive e kësaj vrasje të kualifikuar përfshin privimin e jetës së një personi dhe të çon në rrezik të personit tjetër. Pra flitet për një mënyrë të tillë të ekzekutimit, me të cilin kryerësi afrohet, ose pranon të rrezikojë jetën e një personi tjetër gjatë vrasjes.Vrasja është kryer duke ndërmarrë një veprim përgjithësisht të rrezikshëm ose një mjet përgjithësisht të rrezikshëm (hedhja e një bombe ose paisje tjetër eksplozive në një grup njerëzish, përdorimi i armëve të zjarrit, etj), rrezikimi i jetës së një personi tjetër është një nënprodukt i kryer i vrasjes.²²Rreziku që krijohet duhet të jetë i menjëhershëm dhe specifik.Ndërsa nga ana subjektive, duhet të ketë vetëdije se jeta e tij është në rrezik, si dhe ndjenja e privimit nga jeta e tij. Nëse kryerësi është i vetëdijshëm për privimin e të gjithë personave (të një grupi) do të konsiderohet si një akt i kryerjes së vrasjeve të tilla. Fajësia mund t'i ngarkohet për veprën e tillë, nëse kryerësi ka qenë i vetëdijshëm për rrezikshmërinë

²¹Kambovski.V&Zejneli.I, E drejta penale e përgjithshme, Tetove, 2018,fq-148

²² Ismail Zejneli, E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Tetovë, fq 22.

permanente dhe e ka dëshiruar atë, apo nëse ka qenë i vetëdijshëm për mundësinë e shkaktimit të saj dhe është pajtuar me një situatë të tillë. Në rastet kur kryerësi me dashje shkrep me armë zjarri në drejtim të masës së njerëzve, me qëllim apo me dakord që të goditen shumë persona, atëherë do të konsiderohet se është kryer vepra penale e vrasjes apo tentative e vrasjes së dy apo më shumë personave.

1.5 Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore

Fakti që ndokush e vret tjetrin me qëllim të fitimit të dobisë pasurore është tregues se bëhet fjalë për egoizëm ekstrem dhe motiv të paskrupullt që me çdo kusht të fitohet pasuri. Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore konsiderohet në rastet kur privimi nga jeta i personit tjetër kryhet me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellë ndonjë dobi pasurore, dobi material. Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore ekziston në rastet kur privimi nga jeta e personit tjetër kryhet me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellë ndonjë dobi pasurore. Vrasja është mjet që arrihet deri te dobia material për vetë ose për tjetrin, që shpreh si zmadhim (kështu, p.sh. që të arrihet deri te pasuria e viktimës, deri te shpërblimi i premtuar) ose që t'i shmanget zvogëlimit të pasurisë së kryerësit (kështu p.sh. që të lirohet nga borxhi i vetë ndaj viktimës). Vepra ekziston edhe kur kryerësi vetëm supozon, beson se do ta arrijë dobinë e tillë. Gjithashtu, nuk është e domosdoshme të realizohet fitim kah i cili ka synuar kryerësi,²³ madje, për ekzistimin e kësaj vepre nuk kërkohet që dobia të jetë e kundërligjme. Së këndejmi, edhe ai që vret borxhliun e vet me qëllim që t'i marrë të holla dhe kështu arkëtoj borxhin e vet, konsiderohet se e ka kryer me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellë ndonjë dobi pasurore. Vrasja është mjet që arrihet deri te dobia materiale për vetë ose për tjetrin, që shprehet si zmadhim (kështu, p.sh. që të mund të lirohet nga borxhi i vetë ndaj viktimës). Vepra ekziston edhe kur kryerësi vetëm supozon, beson se do ta arrijë dobinë e tillë. Gjithashtu, nuk është e domosdoshme të realizohet fitim kah i cili ka synuar kryerësi, madje, për ekzistimin e saj vepre nuk kërkohet që dobia të jetë e kundërligjshme. Së këndejmi, edhe ai që e vret borxhliun e vet me qëllim që ti marrë të holla dhe kështu të arkëtojë borxhin e vet, konsiderohet se e ka kryer këtë vepër. Krahas vrasjes së borxhliut, si vrasje e këtillë konsiderohet edhe vrasja me qëllim të trashëgimisë, vrasja e kreditorit me qëllim që të mos paguhet borxhi, vrasja e paguar, vrasja me qëllim të eliminimit të

²³ Ismail Zejneli, E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Tetovë, fq 22.

konkurentit etj. Ky lloj i vrasjes mund të kryhet edhe me dashje eventuale, ngase kryerësi qëllimin e tij për të realizuar dobi pasurore mund ta arrijë edhe në rastin kur është i vetëdijshëm për shkaktimin e vdekjes dhe dekorohet që ajo të shkaktohet.

Shtrohet pyetja ku ekziston dallimi midis kësaj vrasje dhe vrasjeve të rënda të grabitjes dhe vjedhjes grabitqare, me çrast shkaktohet edhe vdekja e viktimës. Dallimi kryesor konstaton në faktin se te grabitja dhe vjedhja grabitqare dhuna dhe kanosja përdoen aty për aty me qëllim të marrjes apo mbajtjes së sendit të vjedhur.

1.6 Vrasja me qëllim të kryerjes apo fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale

Vrasja e tillë ekziston atëherë kur privimi nga jeta e personit tjetër është mjet për realizimin e ndonjë qëllim tjetër, kryerjes së ndonjë veprë apo edhe fshehjen e veprës penale të kryer më herët. Ajo është karakteristikë për të dy situatat. Në të parën (vrasja për shkak të kryerjes së veprës tjetër penale), privimi nga jeta është faza paraprake, veprimi përgaditor për kryerjen e cilës do qoftë vepër penale (kështu, p.sh kur dikush e vret rojtarin që më vonë të hyje në ndërtesë, ose e vret burrin që më vonë të përdhunoj gruan e tij). Vrasja e kualifikuar ekziston pa marrë parasysh se vepra tjetër është kryer në të vërtetë. Situate e dytë, ekziston në rastet kur kryerësi e privon nga jeta personin tjetër, me qëllim që të pengojë zbulimin e veprës penale e cila është kryer më parë.²⁴

1.7 Vrasja nga hakmarrja e paskrupullt

Hakmarrja është një vrasje me paramendim, është prej atyre që zakonisht në fjalorin gjyqësor e penal, tashmë edhe në atë gazetaresk quhen vrasje për motive të dobta. Hakmarrjen me pak fjalë mund ta definojmë si krim, i cili jo gjithmonë mund të jetë një vrasje, por mund të jetë edhe një akt i tipit të pushimit nga puna, i cili vjen si kundërpasojë e një akti që personi ka pësuar më parë. Kjo mund të jetë një sharje, një borxh i pashlyer, një mashtrim i rëndomtë, një tradhti bashkëshortore, një mashtrim në biznes etj. Hakmarrja në thelbin e saj është një krim, një krim pa rregulla, shumë here anonim, një krim që s'mund të kontrollohet po ashtu edhe si vetë mënia e

²⁴ Ismail Zejneli, E Drejta Penale (pjesa e posaçme) Tetovë, fq 23.

races njerëzore. Është një akt violent që ka lindur bashkë me njeriun dhe do të vazhdojë të jetë sa të jetë njerëzimi. Sa i përket nocionit të përgjithshëm të vrasjes nga hakmarrja e paskrupullt asocon në gjakmarrjen. Hakmarrja e paskrupullt ka disa elemente të përbashkëta me hakmarrjen dhe gjakmarrjen por, ka edhe disa dallime të rëndësishme të cilat i përkasin vetë personalitetit të kryerësit të vrasjes nga hakmarrja, siç janë më shpesh: arrsyja që është shkak i kësaj forme të hakmarrjes, personi ndaj të cilit është drejtuar kjo vrasje dhe një varg rrethanash tjera, të cilat mund të gjejnë shprehje me rastin e kryerjes së veprës në fjalë. Në lidhje me personalitetin e kryerësit, sipas mendimit të disa autorëve, nocioni i paskrupullsisë të kjo vrasje, në rradhë të pare është i lidhur me sjelljet negative të njerëzve. Është i pranuar qëndrimi se çdo vrasje nga hakmarrja nuk mund të konsiderohet si vrasje nga hakmarrja e paskrupullt. Një vrasje nga hakmarrja e paskrupullt mund të konsiderohet si e tillë nëse është e drejtuar nga ndonjë person i pafajshëm apo nëse qëllimi i hakmarrjes nuk është në përpjestim me të keqen e shkaktuar më parë.²⁵ Hakmarrjen ndryshe mund ta quajmë edhe si drejtësi të egër ku kryerësin dëshira e hakmarrjes e merr plotësisht përsipër dhe atëherë me paramendim privon nga jeta e një personi, apo grup njerëzish, me çrast mendja dhe shpirti i tij bashkohen për këtë qëllim dhe në mënyrë më të keqe drejtohen drejt krimit. Niveli i lartë i fajit që kryhen kryerësi edhe se vepra konsiderohet e rëndë, është fakti që kryerësi është i motivuar nga dëshira për hakmarrje për disa të këqija të hershme që i ishin shkaktuar atij. Kur bëhet fjalë për këtë fenomen i cili është rrënjësor në shoqëri, rreziku është që ai të nis çdo herë kur lind një konflikt mes dy apo më shumë personave.

1.8 Vrasja nga motivet e ulta

Motivet e ulta nuk janë përcaktuar në ligj, por mund të nxirret nga kontesti i tërë dispozitës dhe nga ajo që karakterizon motivet e ulta të sipër përmendura. Edhe praktika jonë gjyqësore niset nga qëndrimet dhe pamjet etike, morale dhe sociale siç janë p.sh xhelozia, e cila nuk është motiv, por gjendje specifike shpirtërore e një personi, nga ajo gjendje mund të dalin motive të ulta, që duhet në mënyrë të veçantë të verifikohen.²⁶ Më së paku dhjetë vjet burg ose burgim të përgjithshëm do të dënohet personi i cili do të privojë nga jeta tjetrin për levërdi, për të

²⁵Po aty, fq.24.

²⁶Po aty, fq 24.

kryer ose mbuluar ndonjë vepër tjetër, nga urrejtja e pazemërsishme ose motive të ulta. Vrasja nga motivet e ulta paraqitet atëherë kur kryerësi i paraqiten efektet agresive të mbledhura kundër një personi: urrejta, zilia, inatosja, lakmia, intolerance dhe motive të ngjajshme të cilat e shpiejnë deri te ky fenomen. Urrejtja, xhelozia dhe motivet e lartëpërmendura janë paraqitur nga shumë epoka dhe janë prezentuar gjithmonë në këndvështrimin e një reagimi të tmerrshëm, shkatërrues që çon deri në privimin e jetës së tjetrit.

1.9 Vrasja në bazë të porosisë

Dashja e veprës definohet si *orientim subjektiv i veprimit nga kryerësi kah realizimi i pasojës së ndaluar*. Për shkak se jo të gjitha veprat janë vepra të pasojës (delikte formale), me dashje të veprës nënkuptohet *dëshira për ta realizuar figurën ligjore të saj*. Te kryerësi duhet të ekzistojë *raport pozitiv psikologjik* ndaj të gjitha tipareve të veprës penale, dëshirë që të gjitha të realizohen. Kështu p.sh., te vrasja në mënyrë mizore, kryerësi e dëshiron jo vetëm pasojën (vdekjen e viktimës), por edhe *mënyrën* në të cilën ajo realizohet (mizorinë). Të dëshiruarit e pasojës dhe orientimi i pasojës kah shkaktimi i saj është *element i nevojshëm* edhe i tentativës.²⁷

Për dallim nga vrasja nga lakmia (fitimi), kjo vrasje e kualifikuar mund të kryhet edhe nga motivet tjera, që nuk domethënë se synim i saj çdoherë të jetë arritja e dobisë (fitimit) pasuror. Bëhet fjalë, për vrasje të organizuar, në realizimin e së cilës marrin pjesë së paku dy persona: personi që porosity dhe kryerësi i drejtpërdrejtë. Përveç vrasjes së paguar, pas kësaj vrasje të kualifikuar mund të qëndrojnë edhe motive dhe lidhje tjera të kryerësit dhe porositësit, siç mund të jenë lidhjet politike, ekonomike, etj. Duhet theksuar se porositësi përgjigjet si nxitës i vrasjes së rëndë.²⁸

1.10 Vrasja e gruas shtatzënë

Kualifikimi i kësaj vrasje si vrasje e rëndë është tregues se Kodi Penal i kushton mbrojtje më të madhe gruas shtatzënë. Kjo është e arsyeshme, ngase edhe me të drejtën zakonore, si dhe në aspektin human, moral dhe religjioz vrasja e gruas shtatzënë konsiderohet si vrasje më e

²⁷ Kambovski.V&Zejneli.I, E drejta e penale e pergjithshme, Tetove, 2018,fq-150

²⁸ Ismail Zejneli, E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Tetovë, fq 24.

rëndë, në krahasim me vrasjen e rëndomtë. Si në rastet e vrasjes së fëmijës, edhe ky lloj i vrasjes do të konsiderohet se ekziston vetëm nëse kryerësi e ka ditur, ka qenë i vetëdijshëm se objekti i kësaj veprë penale është gruaja shtatzënë. Me së paku dhjetë vjet burgim ose burgim të përjetshëm do të dënohet personi i cili do të privojë nga jeta femrën, të cilën e di që është shtatzënë ose person imitur.²⁹ Vrasja fillon llojin e kualifikimit për shkak të kumulimit të dy të padrejtave, të krijuara me marrjen e dy jetërave: jetës aktuale (të gruas shtatzënë) dhe jetës së ardhshme (foshnjës). Pra, në fakt, fjala është për të ashtuquajturën vrasje e dyfishtë ngase me këtë vepër penale nuk vritet vetëm gruaja shtatzënë, por edhe fëmija i saj i cili ende nuk ka lindur. Paramendimi i kryerësit duhet të përmbajë vetëdijen, për karakteristikën e viktimës, për atë se bëhet fjalë për gruan shtatzënë. Ky lloj i vrasjes do të konsiderohet se ekziston vetëm nëse kryerësi ka ditur se objekti i kësaj veprë penale është gruaja shtatzënë. Nëse kryerësi nuk e ka ditur se gruaja të cilën e privon nga jeta është shtatzënë, atëherë kryerësi i kësaj veprë do të përgjigjet për vrasje të rëndomtë, apo ndonjë lloj të vrasjes së rëndë, varësisht nga motivet, rrethanat apo mënyra e kryerjes e jo për kryerjen e kësaj lloji vrasje. Te kjo vepër penale nuk ka rëndësi faza e shtatzanisë. Altruizmi dhe filantropia janë ndjenja që shoqëria duhet t'i kultivojë dhe zhvillojë. Sidoqoftë, ka gjithmonë persona të cilët, përmes sjelljes së tyre shkaktojnë jo vetëm një ndjenjë të papranueshmërisë. Vrasja e një gruaje shtatzënë sigurisht që është një formë e vrasjes së kualifikuar dhe indicative, e cila kryhet nga motivet e ulta dhe pandjeshmëria e kryerësit ku vrasja merr një pamje të tmerrshme dhe merren dy jetë ajo e nënës dhe në të njëjtën kohë shkatërron edhe frytin e saj (jetën e fëmijës së ardhshëm).

Në të vërtetë këtu shkatërimi i fetusit paraqet një pasojë shtesë që shoqëron privimin e jetës së nënës.

1.11 Vrasja nga motivet fisnike (Eutanazia)

Ai i cili do të privojë tjetrin nga jeta për motive fisnike, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri pesë vjet burgim. Mendoj që dënimi i paraparë në bazë të nenit 124 të Kodit Penal është ai i duhuri, pra nuk mund të shqiptohet një dënim më i butë në lidhje me këtë lloj vrasje. Eutanazia, apo ndryshe vdekja e ëmbël sipas greqishtes, është vullneti i pacientit në një

²⁹Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, neni 123.

stad terminal të jetës, apo familjarëve të tij dhe për t'i dhënë fund vuajtjeve përgjithmonë përmes një ndihme mjekësore. Pra, ndryshe mund ta quajmë si përshpejtim i vdekjes.

Me konceptrt filozofike, etike, medicinal dhe jurifike për vdekjen është ndërlidhur ngushtë edhe me çështjen e eutanazisë. Dhënia e ndihmës në vdekje, vdekja e butë, përkatësisht vdekja e butë dhe e lehtë ka të bëjë me situatat e ndryshme: vrasja e personit të sëmurë të pashërueshëm që nuk ka shpëtim dhe është duke vdekur që t'i zvogëlohen dhimbjet gjatë vdekjes, vdekja nga mëshira e një jete të pavlefshme, siç është, vrasja e personit të paaftë për jetë. Për të drejtën penaleproblemi i eutanazisë shtrohet si një problem i legalizimit ose trajtimit më të butë të vrasjes nga mëshira, përkatësisht vrasja në bazë të kërkeses së vetë viktimës. Qasja juridiko-penale ndaj kësaj problematike është determinuar nga shkaqet dhe faktorët e ndryshëm kulturologjik, civilizues dhe historik, si edhe ndikimin e pikëpamjeve dominante filozofike dhe etike. Është e njohur, në rradhë të parë, se kulturat e ndryshme kanë pasur pikëpamje të ndryshme ndaj vdekjes nga mëshira, duke filluar nga ato që e kanë aprovuar dhe përkrahur atë (Sparta, Athina, Roma), e deri tek ato që e kanë kundërshtuar dhe rrefuzuar cilin do qoftë trajtim të privilegjuar të saj. Në disa legjislacione, (në disa legjislacione të shteteve amerikane) është legalizuar e ashtuquajtura eutanazia passive, e cila konsiston në ndërprerjen e mbajtjes së mëtejshme artificial në jetë të pacientit për të cilin është konstatuar (nga konziliumi i mjekëve) se është një rast i pashpresë. Lëvizjet për legalizimin e eutanazisë në legjislacionet europiane fillojnë me miratimin e Ligjit Hollandez (2001) për kontrollin e vrasjeve në bazë të kërkesës së viktimës dhe dhënia e ndihmës gjatë vetëvrasjes. Ligji i përcakton gjashtë kritere sipas të cilëve mjeku mund ta ndërpresë dhënien e ndihmës tjetër dhe t'i ndihmojë në vdekje (me dhënien e inekcioneve special) pacienti gjatë shprehjes së kërkesës së tij të lire dhe të vetëdishme si dhe caktimi dhe verifikimi kolegjial se bëhet fjalë për një rast të pa shpresë.³⁰ Pra, juridikisht një vrasje e mëshirshme ose eutanazia është e konsideruar si vrasje kriminale dhe përdoret shpesh si sinonim i vrasjes së kryerë me kërkesë të bërë nga vetë pacienti. Sai përket kësaj lloj vrasje mendimi im do të ishte reciprok me Kodin Penal, pra nuk do të ishte e drejtë një vrasje e tillë pa marrë parasysh dhimbjeve të viktimës. Nuk mendoj që është një veprim human pasi që nuk jemi ne ato që mundemi t'i shkurtojmë vuajtjet e njeriut, prandaj duhet dhënë dënimi i merituar prej 6 muaj deri 5 vjet burgim kryerësit të një vepre penale të tillë.

³⁰Ismael Zejneli, E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Tetovë, fq 25-26.

1.12 Vrasja nga pakujdesia

Per dallim nga dashja, e përcaktuar si marrëdhënie e kryerësit ndaj veprës që shprehet si dashja e veprës, pakujdesia definohet si *kryerje e padëshiruar, e pavullnetshme e veprës penale*. Ligji dallon dy lloje pakujdesish: me vetëdije dhe pa vetëdije (n.14 KPM). Te *pakujdesia me vetëdije*, kryerësi është i vetëdijshëm për mundësinë e shkaktimit të pasojës (d.m.th. realizimit të veprës), por i mungon *vullneti për realizimin* e veprës. Te *pakujdesia pa vetëdijete* kryerësi nuk ekziston asfarë *vetëdije për mundësinë* e shkaktimit të pasojës së dëmshme, edhe pse ka qenë *i detyruar dhe ka mundur* të jetë i vetëdijshëm për mundësinë e tillë.³¹

Mosekzistimi i raportit të plotë psikologjik (të vetëdijes dhe vullnetit) të kryerësit ndaj veprës së tij e bën *specifike* dhe mjaft të komplikuar çështjen e karakterit të *fajit nga pakujdesia*, ku bazohet këtu *qortimi*. Koncepti psikologjik i koncentruar në dashjen si *dolus malus*, vështirë mund të sqarojë, se pse duhet të konsiderohet i fajshëm ai i cili nuk e ka dashur kryerjen e veprës. Koncepti normativo-psikologjik duhet të sqarojë se ku *fokusohet gjykata për qortueshmërinë* e veprës nga pakujdesia.³²

Ai i cili tjetërkënd do ta privojë nga jeta nga pakujdesia, do të dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në pesë (5) vjet . Vrasja nga pakujdesia konsiderohet se është kryer nëse dikush privohet nga jeta për shkak të pakujdesisë së kryerësit të veprës penale. Vrasja nga pakujdesia paraqet një rrezikshmëri shoqërore më të vogël në krahasim me vetëvrasjet e kryera me dashje. Konsiderohet si formë më e lehtë e vrasjes vetëm për shkak të forms së fajit me të cilin kryhet. Te vrasja nga pakujdesia privimi i ndonjë personi nga jeta manifestohet në mënyrë specifike. Zakonisht këtu bëhet fjalë për veprime të cilat janë ndërmarrë për qëllim tjetër e jo për qëllim të privimit të ndonjë personi nga jeta. Te vrasja nga pakujdesia, shkaktimi i pasojës nuk është i dëshiruar. Subjekti i kryerjes së kësaj vepre penale mund të jetë cilido person që ka arritur moshën e duhur dhe që është i përgjegjshëm. Lidhur me anën subjektive (pakujdesia) është irelevante se a bëhet fjalë për pakujdesi të vetëdijshme apo të pavetëdijshme.³³

³¹ Kambovski.V&Zejneli.I, E Drejta e penale e pergjithshme, Tetove, 2018,fq-155

³² Po aty

³³ Ismail Zejneli, E Drejta Penale (pjesa e posaçme), Tetovë, fq 22.

KAPITULLII

2.FAKTORËT QË NDIKOJNËNËVEPRËN PENALE TË VRASJES

FAKTORËT OBJEKTIV (TË JASHTËM)

Sa i përket faktorëve me anë të cilëve nënkuptojmë rrethanën e një force lëvizëse që ndihmon në kryerjen e një pune , pra punë me anë të cilës përcakton rrugën e zhvillimit të njëdukurie në kriminalitet na shfaqen në dy grupe, pra faktorët objektiv dhe subjektiv. Në këtë kapitull do të mundohem të shtjelloj rrethanat të cilat na shpiejnë në këtë dukuri mjaft të ndërlikuar. Sipas mendimeve të disa kriminologëve, ndikim më të madh në paraqitjen e kriminalitetit e kanë faktorët e jashtëm kriminogjen. Sipas tyre, faktorët e jashtëm ose egzogjen, paraqesin kushtet dhe rrethanat determinuese të sjelljes kriminale. Ata, ndikojnë drejtpërsëdrejti në paraqitjen e aktiviteteve kriminale në shoqëri. Faktorët objektiv janë të shumtë dhe secili ka rëndësinë dhe rolin e vet në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Në literaturë e cila trajton problematikën e faktorëve kriminogjenë, kemi disa ndarje të faktorëve të jashtëm. Nga kërkimet empirike kriminologjike, e sidomos duke marrë parasysh rezultatet e shënimeve dhe të dhënave statistikore mbi kriminalitetin, në shumë vende vërehet se disa faktorë objektiv, kanë një ndikim më të madh se sa faktorët e tjerë. Kësisoj, si faktorë me ndikim të dukshëm në paraqitjen e sjelljeve kriminale trajtohen: grupi i faktorëve ekonomiko-shoqërorë, faktorët ideopolitik, mikrogruporë, sociopatologjikë dhe të tjerë.³⁴

Në Kriminologjinë bashkëkohore, lidhur me ndikimin e faktorëve objektive ekonomiko-shoqërorë, ka mendime dhe pikëpamje të ndryshme. Në këtë drejtim, theksohet se zhvillimi i hovshëm industrial, të arriturat e mëdha teknike, zhvillimi i elektronikës dhe një varg transformimesh të mëdha që janë bërë në shoqëri, kanë ndikuar edhe në proceset e formimit të njeriut dhe personalitetit të tij. Këto të arritura dhe transformime të mëdha, në një anë kanë

³⁴ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq.231.

kontribuar në krijimin e një mirëqenie dhe standardi të lartë, në anën tjetër, me miliona njerëz vuajnë nga uria, skamja, papunësia dhe sëmundjet e ndryshme. Të gjitha këto kanë ndikim të caktuar në veprimet dhe sjelljet kriminale. Në botën bashkëkohore vërehen një varg procesesh dhe kontradiktash të kushteve bashkëkohore të jetës. Në një anë zhvillohen gara për dominim ekonomik dhe teknologjik, gara në armatimin bërthamor, gara në pushtimin e kosmosit, e në anën tjetër janë të pranishme luftërat, skamje, mjerim, ekzoduese dhe vdekje massive të popullatës nga uria.

2.1 Varfëria

Konsiderohet një faktor objektiv i kriminalitetit i cili ndikon në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Në literaturën kriminologjike flitet për ndikimin e madh që kanë kushtet e vështira material dhe varfëria në paraqitjen e kriminalitetit. Ato janë prezente veçanërisht në kohën e krizave dhe depresioneve ekonomike. Për ndikimin e madh të skamjes dhe varfërisë në paraqitjen e dukurive negative, ka bërë fjalë edhe filozofiantik Aristoteli i cili ka theksuar se “varfëria është nëna e krimit, ndërsa begatia nëna e amoralitetit”. Edhe sot e kësaj dite, në literaturën kriminologjike ka mendime të ngjashme të cilat theksojnë lidhjen mes varfërisë dhe kriminalitetit. Në këtë drejtim, ka edhe mendime të cilat theksojnë se kriminaliteti është produkt i shtresave të varfëra të popullsisë ndërsa me kriminalitet merren fare pak shtresat e pasura. Është e vërtetë e madhe dhe e pakontestueshme se kushtet material, e sidomos skamja, ndikojnë fuqishëm në sjelljet dhe qëndrimet e individëve dhe grupeve të caktuara. Varfëria dhe skamja mund të ushtrojnë ndikim në sjelljet dhe qëndrimet e disa individëve sidomos disa individë të cilët edhe ashtu janë zhytur në veprime dhe sjellje kriminale.

Varfëria mund të çojë në nivele të larta stresi që nga ana tjetër ajo mund të bëhet shkak që individët të kryejnë vjedhje, plaçkitje ose akte të tjera të dhunshme. Për më tepër, varfëria mund të çojë në një arsim inferior aktual ose të perceptuar, i cili do të bëjë që të rinjtë të kenë më pak akses në shkollë cilësore, punë dhe modele të roleve, duke zvogëluar kostot e mundësive të krimit dhe duke rritur probabilitetin e të rinjve që kalojnë kohën në shoqërimin e rrugës. Krimi ofron një mënyrë në të cilën njerëzit e varfër mund të marrin sende materiale të cilat nuk mund t'i arrijnë përmes mjeteve të ligjshme. Shpesh kërcënimi ose forca mund t'i ndihmojë ata të fitojnë edhe më shumë mallra, kjo i nxit ata të kryejnë vepra penale. Për shumë njerëz të varfër, çmimi që jep krimi mund të tejkalojë rrezikun e kapjes, veçanërisht duke pasur parasysh që

kostoja e tyre e mundësive është më e ulët se ajo e një personi më të pasur. Kështu, varfëria rrit shkallët e krimit.³⁵ Hulumtimet kriminologjike të bëra në vende të ndryshme të botës, vërtetojnë se numri më i madh i delikuentëve të mitur rrjedhin prej familjeve dhe grupeve sociale që kanë problem dhe vështirësi material.³⁶ Sipas një hulumtimi të bërë, 33 % e qytetarëve mendojnë të shpërngulen ndërsa 52% e të rinjëve që kanë më pak se 29 vjet janë deklaruar se do të emigrojnë jashtë Maqedonisë së Veriut. Hulumtimi tregon se për më pak se gjashtë muaj, numri i qytetarëve që mendojnë për t'u shpërngulur nga vendi është rritur për rreth katër përqind, meqëdy e treta e qytetarëve nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet mujore.

2.2 Papunësia

Sa i përket papunësisë, mund të themi se është një vëzhgim i zakonshëm për shumë vende që nivelet e saj dhe nivelet e krimit janë të lidhura pozitivisht. Një çështje më e diskutueshme është se vallë papunësia shkakton krimin, apo krimi shkakton papunësinë apo faktorët e tretë i shkaktojnë të dyja. Papunësia është njëfaktor i madh sa i përket kriminalitetit. Mendoni për një minutë? Nëse e humbisni punësimin ose të themi burimin e të ardhurave për ndonjë arsye, mund ta gjeni veten në një pozicion të rrezikshëm ku nuk mund të mbështetni veten ose familjen tuaj. Papunësia është e ngjajshme me dukurinë e varfërisë dhe ka të bëjë me pamundësinë e punësimit dhe kyçjes në punë të njerëzve, e kjo sjell mungesën e mjeteve për ekzistencë. Papunësia, si dukuri dhe problem social, veçmas vjen në shprehje gjatë krizave dhe recesioneve ekonomike. Papunësia ndikon në kënaqësimin e pozitës material të individëve dhe familjeve. Nëse kjo dukuri zgjat më tepër, atëherë sjell varfëri dhe skamje të madhe. Gjendja e papunësisë ushtron efekte negative, si në aspektin social ashtu edhe në atë individual. Për shkak të pamundësisë së plotësimit të nevojave elementare për jetesë, të antarëve të familjeve, për shkak të pamundësisë së shkollimit dhe mbrojtjes shëndetësore, pason braktisja e shkollës dhe mësimi, paraqitja e sëmundjeve dhe e sjelljeve kriminale. Nga ana tjetër, vetë atmosfera e krijuar për shkak të papunësisë, ndikon në gjendjen psikike dhe shpirtërore të individëve dhe familjeve të caktuara. Në këtë mënyrë, janë të shpeshta konfliktet dhe mosmarreveshjet në familje, në mes bashkëshortëve, në mes fëmijëve dhe prindërve dhe dukuri të tjera negative. Për shkak

³⁵ <http://economics.fundamentalfinance.com/povertycrime.php>

³⁶ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 237.

tëkonflikteve të tilla, ndodh shthurja dhe shkatërrimi i familjes, dhënia e anëtarëve të familjes pas konsumimit të alkoolit, drogës, dhe marrjes me aktivitete tjera negative. Gjendja e papunësisë shkakton një apati dhe zhgënjim i cili lidhet me paperspektivën e zgjidhjes së problemeve të cilat krijohen në familje dhe individë. Kriminologu i njohur francez J. Konstant, papunësinë dhe problemet të cilat krijohen te individët dhe familjet, i konsideron si faktorë dhe rrethanë që i paraprijnë krimit në shoqëri. Gati të gjitha vendet ku është shtuar papunësia, vërehet edhe rritja e formave të ndryshme të kriminalitetit, megjithëse kjo nuk do të thotë se kriminaliteti automatikisht do të rritet nëse shtohet papunësia. Sa i përket papunësisë në Maqedoni shkalla e saj është **20.8%**. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për statistika, në tremujorin e III-të të vitit 2018, popullsia aktive në Republikën e Maqedonisë është 958.770 persona, nga të cilët 759.445 janë të punësuar dhe 199.325 janë të papunë. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror për statistika, në tremujorin e II të vitit 2018, popullsia aktive në Republikën e Maqedonisë ishte 957.471 persona, nga të cilët 755.073 ishin të punësuar dhe 202.398 ishin të papunë. Shkalla e aktivitetit në këtë periudhë është 56.9, shkalla e papunësimi është 44.9, ndërsa shkalla e papunësisë është **21.1%**.³⁷

2.3 Migrimi i njerëzve

Problem i emigrimit dhe prania e të huajve, në shumë vende po shkakton kundërthënie dhe sjellje deviante e kriminale. Autorët gjerman Schwind, Kaiser, Goppinger etj., në studimet e tyre kriminologjike flasin për kriminalitetin e të huajve dhe një pjese të shtimit të disa veprimeve kriminale, ua përshkruajnë atyre dhe procesit të migrimit të popullsisë prej një vendi në vendin tjetër. Me siguri se ardhacakët ose të huajt kryejnë krime në këto vende, por është fakt se në këtë drejtim ka tendenca që këtyre t'u vishet, pa bazë dhe pa prova të verifikuara, kryerja e disa sjelljeve kriminale dhe rritja e kriminalitetit në këto vende. Në literaturën bashkëkohore kriminologjike dhe në raporte të ndryshme të organizatave ndërkombëtare, të cilat përcjellin migrimin e popullsisë dhe lëvizjen e refugjatëve, thuhet se numri i tyre është rritur disa herë në krahasim me disa dekada më parë. Siç dihet, shtimi i numrit të refugjatëve dhe azilkërkuesëve, është rritur për shkak të konflikteve politike, krizave ekonomike e luftërave lokale, çregullimeve sociale, për shkak të katastrofave të ndryshme natyrore dhe për shkak të shkeljeve e cënimeve të drejtave dhe lirive të njeriut në shumë shtete dhe religjione të botës. Lëvizja e refugjatëve dhe

³⁷ <https://telegrafi.com/papunesia-ne-maqedoni-ka-shenuar-renie-te-lehte/>

azilkërkuesve, zakonisht shkon prej vendeve të përfshira me konflikte e luftëra civile, të varfëra dhe të pa zhvilluara, drejt vendeve të zhvilluara dhe demokratike. Dukuritë e përmendura, në botën bashkëkohore edhe më tej po nxisin migrimin e popullsisë, e sidomos të rinjtë, prej vendeve të pazhvilluara në vendet e zhvilluara. Këkisoj, sot vërehet një vështirim i migrimit të rinjtë dhe qytetarët, prej vendeve në të cilat nuk ka zhvillim dhe transformim të duhur ekonomiko-material dhe vendeve në të cilat paraqiten kundërtënie, konflikte dhe tronditje të mëdha politike, drejt vendeve industriale më stabile. Ardhasakët, në vendet industriale dhe të zhvilluara, shpeshherë nuk janë të mirëseardhur, ata hasin në vështirësi dhe pengesa të ndryshme. Në shumë raste, ata nuk mund t'i realizojnë dëshirat dhe qëllimet për të cilat kanë ardhur në këto vende industriale. Problem i vaçantë për ardhasakët, është vendstrehimi i tyre, punësimi dhe sigurimi i ekzistencës. Shpeshherë, këta persona të ardhur, përveç problemeve administrative dhe teknike, ndeshen edhe me një varg problemesh që kanë të bëjnë me adaptimin dhe përshtatjen e tyre në kushtet e reja të jetesës. Kjo gjendje, të këta persona, shpeshherë nxitë konflikte dhe mosmarreveshje të ndryshme, trauma shpirtërore të cilat pastaj reflektohen edhe në sjelljet dhe qëndrimet e tyre. Nuk janë të rralla rastet dhe dukuritë që personat e këtillë të jepen pas sjelljeve dhe aktiviteteve të ndryshme kriminale. Për shkak të pengesave të cilat paraqiten lidhur me punësimin dhe vëndosjen e tyre, e vetmja mënyrë e sigurimit të kushteve për jetesë, shpesh ngel marrja me aktivitete të dyshimta antisocial dhe kriminale.³⁸ Sa i përket migrimit, nga Statistikat e marra në Entin Shtetëror vërehet se gjatë këtij viti kanë emigruar 2322 persona nga Republika e Maqedonisë së Veriut, prej të cilëve 36 persona në Bosnje dhe Hercegovinë, 10 persona në Sloveni, 258 persona në Sërbë, 224 persona në Kosovë, 39 persona në Kroaci, 27 persona në Mal të Zi, 166 persona në Shqipëri, 51 persona në Bullgari, 56 persona në Greqi, 918 persona në Turqi dhe 536 persona në drejtim të paditur. Kushtet e vështira për jetës, vështirësi të ekonomike e materiale janë faktorët primar të cilët e shpiejnë popullatën të largohen dhe braktisin vendet e tyre. Sa i përket qytetit tim poashtu kemi një rritje të madhe në numrin e personave që migrojnë. Në bazë të statistikave të marra, në Gostivar gjatë këtij viti kanë migruar 118 persona, prej tyre 11 janë të moshës 15-30 dhe 23 të moshës 30-64, 5 persona +65 vjeçar, 20 persona të mirguar familjarisht dhe të tjerët nuk dihen.³⁹

³⁸ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 234-235.

³⁹ <http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=9>

2.4 Kushtet e vështira të banimit

Kushtet e vështira të banimit si faktorë kriminogjen, gjithashtu zënë vend të rëndësishëm në trajtimet dhe kërkimet empirike të etiologjisë kriminale. Problemi i banimit, e sidomos mungesa e zgjedhjes së çështjes së banimit adekuat, është i lidhur me procesin e migrimin të popullsisë, me përqëndrimin e saj nëpër qendra dhe qytete, me lëvizjet masovike prej viseve fshatare drejt viseve urbane dhe industriale. Për shkak të lëvizjeve të mëdha të popullsisë dhe ardhjes stihike nëpër qendra urbane dhe industriale, krijohet situatë e mungesës së hapësirës banesore. Për këtë arsye, shpeshherë, me qëllim të zgjidhjes provizore të problemit të banimit, ndodh që nëpër kuarte dhe lagje periferike të këtyre qendrave, të lindin kuarte të ngritura shpejt e shpejt, pa kurrfarë plani urbanistik, pa zgjidhjen e problemeve të ndryshme të infrastrukturës, të rrjetit të institucioneve shkollore, shëndetësore dhe kulturore. Nëpër këto kuarte dhe qendra vërehet një grumbullim i madh i popullsisë, një dendësi e madhe e cila i ashpëson raportet në mes qytetarëve dhe nxit kundërthënie të ndryshme. Nga kërkimet dhe hulumtimet kriminologjike të këtij faktori, vërehet se nëpër banesa dhe dhoma joadekuate, vëndosen disa familje me shumë antarë, kështu që qëndrimi dhe jetesa në to është shumë e vështirësuar. Kjo situatë ndikon që të miturit dhe të rinjtë, shpeshherë për shkak të kushteve të vështira të banimit, të braktisin familjen, të kërkojnë zgjedhje të tjera duke u marrë me sjellje dhe veprime të ndryshme kriminale. Nuk janë të rralla rastet e ikjes së të miturve dhe të rinjëve nga familja, dhënia e tyre pas shoqërimit me grupe problematike dhe kriminale të të rinjëve, dhënia pas prostitucionit, narkomanisë e dukurive tjera devijante. Prandaj, me të drejtë, shumë autorë, kushtet e banimit i vejnë në raport me disa sjellje dhe veprime kriminale.⁴⁰

FAKTORËT SUBJEKTIV (TË BRENDSHËM)

Sado që faktorëve të jashtëm apo objektiv u takon një rol me rëndësi në paraqitjen e sjelljeve kriminale, dukuria e kriminalitetit dhe shkaqet e saj, nuk mund të shpjegohen drejt dhe deri në fund pa analizën dhe ndikimin e faktorëve të brendshëm, subjektiv, të cilët kanë të bëjnë me personalitetin e kryerësit. Kur flitet për faktorët subjektiv, zakonisht mendohet për individin, për personalitetin e njeriut, në rastin konkret, të njeriut delikuent. Në këtë drejtim, posaçërisht theksohet roli dhe rëndësia e jetës së tij biopsikike dhe lidhjet e saj me sjelljet dhe veprimet

⁴⁰ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 241.

kriminale. Në literaturën kriminologjike ekziston një bindje e arsyeshme më bukur e përhapur se vetitë biologjike dhe psikike shumëherë janë komponentë me rëndësi vendimtare në jetën e njeriut. Varësisht se si janë të zhvilluara dhe si funksionojnë, ato kanë ndikim në sjelljet dhe qëndrimet e njerëzve. Thuhet se ndikimet e faktorëve të jashtëm në sjelljet dhe veprimet e personalitetit varen shumë nga vetë struktura biologjike dhe psikike e atij individit. Nëse ajo strukturë është normale, nëse është e zhvilluar në mënyrë harmonike, nëse nuk ka defekte dhe anomali, atëherë personaliteti i njeriut është më rezistent ndaj ngacmimeve dhe ndikimeve që vijnë nga jashtë, nga veprimi i kushteve dhe faktorëve objektiv dhe anasjelltas. Prandaj, pikërisht këtu qëndron rëndësia e njohjes dhe shpjegimit të faktorëve subjektivë. Në literaturë kriminologjike, faktorët subjektivë të sjelljes kriminale, zakonisht ndahen në faktorë psikologjik ose psikikë dhe në faktorë biologjik!⁴¹

2.5 Karakteri

Karakterit është një nga vetitë kryesore të personalitetit të njeriut. Karakteri konsiderohet si cilësi esenciale e një personaliteti. Në literaturën psikologjike, shpeshherë, kuptimi ose nocioni karakter identifikohet me nocionin personalitet. Kësisoj, në të folurit e përditshëm, dëgjohet të thuhet për një njeri se ai është “karakter i fortë” ose “karakter i dobët” apo “ai është personalitet i fuqishëm” apo “personalitet stabil” ose “i dobët”, “labil” etj. Mirëpo, kuptimi ose nocioni karakter, këtu paraqet vetëm një veti psikike të një individit të një personi, e jo individin komplet apo personalitetin e tij. Megjithatë, kur flitet për karakterin, zakonisht mendohet për vetitë më të qenësishme të individit apo për cilësitë të cilat vulojnë tërë aktivitetin njerëzor të tij. Kështu, si komponenta të karakterit, në literaturë psikologjike dhe kriminologjike konsiderohen: vullneti, qëndrueshmëria, vendosmëria, konsekuenca, iniciativa, guximi, besnikëria, altruizmi, stabiliteti, siguria etj.

Me karakter, duhet kuptuar, para së gjithash, sistemin e tipareve dhe vetive të personalitetit të cilat tregojnë si vepron individit, përballë disa parimeve dhe vlerave morale të shoqërisë së caktuar. Pra, si karakter trajtohen të gjitha ato veti që tregojnë qëndrimin e individit ndaj disa parimeve, vlerave dhe rregullave morale dhe etike të shoqërisë apo ambientit

⁴¹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 321.

të caktuar. Karakteri i njeriut, në rend të parë, është produkt i edukatës. Tiparet e karakterit formohen në procesin e socializimit të njeriut. Në këtë proces, rol dominues kanë familja, shkolla dhe ambient social. Sipas mendimit që mbretëron sot në psikologjinë bashkohore, si cilësi të personalitetit me karakter duhet të konsiderohen ato veti që vëhen në lidhje me disa parime etike që vlejnë në një shoqëri dhe të cilat parime vlerësohen si të domosdoshme, normale, të lejuara, të drejta, të dobishme dhe të moralshme. Guximi, ligësjtë, ndërgjegjja e lartë ose e ulët, nderi dhe vetitë tjera, gjithashtu konsiderohen si elemente që përbëjnë nocionin e karakterit të një individi. Prandaj, me fjalën karakter, kuptohet një sistem i integruar vetish të individit. Cilësitë e këtyra të karakterit, individit i mundësojnë, që megjithë pengesat në jetën e përditshme, të veprojnë në mënyrë konsekuente në drejtim të sjelljes së tij, në pajtim me normat morale apo juridike të shoqërisë. Si individë me karakter të fortë cilesohen personat që flasin të vërtetën, që e mbrojnë të vërtetën, persona që nuk gënjejnë, persona që nuk u nënshtrohen motiveve dhe interesave të ulta dhe lakmisë material. Si persona me karakter konsiderohen edhe personat që kanë konsekuente në qëndrimet dhe pikëpamjet e tyre për ndonjë çështje apo për ndonjë problem. Të atillë konsiderohen edhe individë të cilët me aftësinë dhe fuqinë e tyre angazhohen në gjykimin dhe eliminimin e padrejtësive dhe të këqijave të ndryshme ndaj njerëzve të tjerë.

Përkundrazi, si persona me karakter të dobët konsiderohen ata individë të cilëve u mungojnë këto veti. Shikuar nga ky aspekt, zakonisht, ndër kryerësit e veprave penale dhe sjelljeve delikuede, më së shpeshtindeshemi me persona që nuk i kanë këto virtyte dhe veti positive të karakterit. Disa autorë, si veti dhe tipare të karakterit, përmendin nderin, altruizmin, ndërgjegjshmërinë, vetëbesimin, ndershmërinë, vetëkritikën, konsekuencën, stabilitetin, labilitetin, modestinë, egoizmin, guximin, frikën, sinqeritetin, agresivitetin, këmbëngulësinë dhe veti tjera.

Të gjitha këto dhe vetitë tjera, janë të rëndësishme në shpjegimin e sjelljeve negative dhe delikuede, në praktikën gjyqësore. Prandaj, karakteri, si veti e strukturës psikike të individit, ka rëndësi për shpjegimin e shumë sjelljeve delikuede. Është e domosdoshme që gjatë ndriçimit të çdo sjelljeje kriminale të individit, të njihet edhe karakteri i personalitetit të atij individi. Njohja e tipareve dhe vetive të karakterit të kryerësit të krimit apo sjelljes tjetër delikuede, ndihmon në ndriçimin e shkaqeve të sjelljes kriminale. Dhe, njëherë, kjo është me rëndësi edhe për procesin e rehabilitimit dhe risocializimit të personit të dënuar sepse, pa njohjen e vetive që kanë të bëjnë me

karakterin, është vështirë të bëhet përmirësimi i personave të dënuar dhe të arrihen rezultate më të mira nëpengimin e kriminalitetit në një shoqëri.⁴²

2.6 Temperamenti

Temperamenti është një veti dhe cilësi me rëndësi psikike për individin, e cila manifestohet në reagimin e tij ndaj ngacmimeve dhe nxitjeve të ndryshme, të jashtme. Disa autorë theksojnë se temperamenti është një veti psikike e personalitetit e cila ka të bëjë me reagimet e tij emocionale, sidomos me intensitetin e reagimeve të tilla. Të tjerët mendojnë se temperamenti duhet të cilësohet si reagim komplet psikik i njeriut, e jo vetëm si një reagim emocional. Temperamenti nuk paraqet vetëm mënyrat e reagimit psikik, ai nënkupton shpejtësinë dhe zgjatjen e reaksioneve të individit ndaj ngjarjeve dhe ngacmimeve, të ambientit i cili e rrethon. Për këtë arsye, disa autorë, me të drejtë, me nocionin “temperament” nënkuptojnë mobilizimin e energjisë që disponon individi në drejtim të caktuar. Në literaturën e psikologjisë së personalitetit dhe psikologjisë së përgjithshme, përmenden disa klasifikime apo ndarje të tipave të ndryshëm të temperamentit. Kësisojë janë të njohura klasifikimet e Hipokratit, Pavlovit, Sheldonit, Krecmerit dhe të tjerëve. Klasifikimi më i njohur dhe më i vjetër i tipave të temperamentit, është ai i filozofit dhe mendimtarit të njohur grek, Hipokratit. Sipas tij njerëzit ndahen në katër tipe themelore të temperamentit: kolerik, sanguinik, flegmatik dhe melankolik. Më poshtë i kemi paraqitur këto lloje temperamentesh.

Temperamenti kolerik: si tip i individit, manifestohet me ndjenja dhe emocione intensive, me vendosjen e lehtë për të ndërmarrë ndonjë aktivitet apo veprim. Ky tip i personalitetit shqetësohet shpejt, për gjëra të imta dhe të vogla bie në konflikt me individë dhe persona të tjerë. Gjithashtu, këta tipa zemërohen e hidhërohen shpejt dhe këtë gjendje e manifestojnë gjatë dhe haptas. Personat e tipit kolerik nuk janë sa duhet stabil, cilësohen me emocione të vrullshme. Këta persona, shpeshherë janë vendosur në ndërmarrjen e disa veprimeve, e nga ana tjetër lehtë bien edhe në gjendje afektive të cilat janë të disfavorshme për ambientin dhe rrethin i cili i shoqëron. Këto veti të këtij tipi të temperamentit, ndikojnë në paraqitjen e disa sjelljeve negative të cilat u paraprijnë aktiviteteve devijante dhe kriminale. Këta tipa lajmërohen në situatë të çrregullimeve dhe tronditjeve që ndodhin në shoqëri sidomos gjatë krizave ekonomike,

⁴² Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 322-324.

luftërave, papunësisë, varfërisë, konflikteve në familje etj. Këto rrethana ata i tejkalojnë me vështirësi dhe në raste të shumta, tronditjet e tilla i përfetojnë në mënyrë të rënde dhe aktiviteti i tyre delikuent shpeshherë arsyetohet nga këto ndikime.

Temperamenti sanguinik: I përket tipit të personave që gjithashtu reagojnë shpejt, me vrull, mirëpo emocionet e tyre nuk janë aq të fuqishme dhe nuk zgjasin shumë. Edhe këta persona e ndërrojnë disponimin lehtë. Shpeshherë, prej zemërimit të madh kalojnë në gëzim e hare. Reaksionet e tyre ndaj ngacmimeve të jashtme janë të shpejta dhe të atypëratyshme, po nuk zgjasin shumë sikur te tipi kolerik. Këta persona, shpesh i kryejnë disa sjellje kriminale në afekt, në çaste të cilat në literaturën e psikologjisë kriminale shpjegohen si gjendje psikike shpirtërore të veçanta.

Temperamenti flegmatik: paraqet tipin e personit i cili me sjelljet dhe qëndrimet e veta reagon në mënyrë të ngadalshme dhe rrallë shqetësohet, ndërsa emocionet i ka më të dobëta dhe vështirë manifestohen. Për këtë tip është karakteristike reagimi i qetë dhe stabil. Personat që i përkasin këtij tipi, veprimet e ndryshme delikuede dhe kriminale i kryejnë me paramendim. Kur shtrihet përgjegjësia e tyre dhe qëndrimi ndaj sjelljeve të tilla, vërtetohet se nuk ndiejnë fort përgjegjësi për veprimet dhe sjelljet të cilat i kanë shkaktuar. Nga ana tjetër, këta persona, rrallëherë paraqiten si përsëritës apo recidivistë të sjelljeve kriminale.

Temperamenti melankolik: është një tip i veçant i personalitetit, i cili është bukur i përhapur në jetën e përditshme, e gjithashtu edhe në praktikën gjyqësore. Te këta persona, është karakteristike që janë të tërhequr në vetvete, se reagojnë me vonësë, janë të pavendosur.

Tipat melankolikë, më rrallë kryejnë krime, mirëpo krimet e tyre, random janë të rënda, të përcjellura me intensitet të fushishëm të emocioneve. Nga literatura kriminologjike dhe praktika gjyqësore, përdoren raste dhe shembuj të ndryshëm të cilët flasin për krimet dhe kriminelët e njohur që kanë kryer vepra penale për shkak të faktit se ika përshkuar xhelozia e madhe dhe si i tillë janë cilësuar persona me temperament melankolik.⁴³

2.7 Inteligjenca

Është një veti me rëndësi e personalitetit, e cila ka ndikim të madh në sjelljet dhe veprimet e tij në jetën e përditshme. Inteligjenca, në psikologji përkufizohet si aftësi e të

⁴³ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 324-326.

menduarit, e zgjedhjes së problemeve dhe orientimit në situatë të ndryshme, e ndërtimit të koncepteve abstrakte dhe e zgjedhjes së detyrave e problemeve që parashtrihen në jetën konkrete të personalitetit. Mendohet se intelegjenca paraqet një aftësi unike, pra ajo është një tërësi e vetëdijes dhe aftësive të personalitetit. Mirëpo, ka edhe mendime se intelegjenca përbëhet prej një varg aftësishë. Në literaturë përmenden disa faktorë të cilët e përcaktojnë intelegjencën e individit.

Psikologu i njohur amerikan L. Terson përmend shtatë faktor të intelegjencës:

1. Aftësia e të folurit rrjedhshëm dhe gjetja e shprehjeve më adekuatë
2. Aftësia e të kuptuarit të përmbajtjeve të formulara në fjalë
3. Aftësia e të operuarit me numra dhe veprime aritmetikore
4. Aftësia e paraftimit dhe të mbajturit mend të proceseve apo ngjarjeve
5. Aftësia e të mbajturit mendë memorjes dhe reproduktimit të përshtypjeve
6. Aftësia e të perceptuarit të hapsirës, sendeve dhe ndryshimeve që ndodhin në ambientin që na rrethon
7. Aftësia e rezonimit apo e përkufizimit, përmbledhjes së raporteve, fakteve, të dhënave të ndryshme, me pak fjalë, kjo aftësi mbështetet me shprehjen koncize të përmbajtjeve të cilat janë të gjata.⁴⁴

Siç po shihet, intelegjenca, si veti psikike e individit, është mjaft komplekse dhe përbëhet prej një varg faktorësh dhe aftësish të cilat e përcaktojnë lartësinë, vëllimin dhe kualitetin e intelegjencës së një individi. Në literaturën psikologjike dhe kriminologjike, theksohet se intelegjenca paraqet një sferë me rëndësi të jetës shpirtërore të secilit njeri dhe si e tillë, ajo ushtron ndikime të shumta në veprimet dhe sjelljet e njeriut. Personat të cilët kanë aftësi që këto procese dhe situatë t'i zgjedhin në mënyrë të favorshme, më pak vijnë në situatë të merren me veprime dhe sjellje delikvente. Në raste të caktuara, intelegjenca mund të përdoret për kryerjen më të lehtë të disa veprimeve kriminale.⁴⁵

2.8 Emocionet

Njeriu, edhe pse është qenie racionale, nuk vepron gjithëherë kështu, por shpeshherë, është i detyruar të ndërmarë disa veprime dhe sjellje që nxitën gjendje të posaçme emocionale të cilat ndikojnë shpeshherë në sjellje dhe veprime kriminale. Për këtë arsye theksohet se ndjenjat

⁴⁴ N. Roti, Psikologjia e përgjithshme, 1968, Prishtinë, fq 164-167 (Ragip Halili, Kriminologjia, 2011, Prishtinë, fq.346)

⁴⁵ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 328-329.

apo emocionet paraqesin përjetime subjektive të njeriut ndaj asaj që ai didhe vepron, ndaj të tjerëve dhe ndaj sjelljeve dhe veprimeve të veta. Këto përjetime emocionale të njeriut, emërohen me fjalët: afekt, brengosje, dashuri, dhimbje, frikë, gëzim, hidhërim, kënaqësi, lemëri, mallëngjim, neveri, shpresë, dëshprim, tmerr, zemërim etj. Emocionet janë veti psikike të cilat mund të trashëgohen nga paraardhësit, por edhe të fitohen në procesin e të mësuarit gjatë formimit të individit, në jetën e përditshme. Personat që kanë probleme emocionale, veçmas ato që emocionalisht janë jostabil, të shqetësuar dhe të tronditur në jetën e përditshme, më lehtë vijnë në situatë të kryejnë vepra kriminale. Nga praktika gjyqësore dhe rezultatet e hulumtimeve empirike, konstatohet se te individët me çrregullime të forta emocionale, shpesh vërehen disa shenja të veçanta, si skuqja e tepërt, zverdhja, dridhja e duarve apo gjymtyrëve të tjera, djersitja dhe shenja të tjera. Këto gjendje emocionale janë rezultat i ndryshimeve të funksionimit të organeve të ndryshme vitale, si zemra, sistemi nervor, organet e frymemarrjes, etj. Në gjendje të tilla emocionale ndodh që disa persona të kryejnë sjellje dhe veprime kriminale. Jostabiliteti emocional, ndjenjat intensive, gjendjet afektive, janë rrethana të shpeshta që përmenden si shkaqe të paraqitjes së sjelljeve kriminale në praktikën gjyqësore. Prandaj ndjenjat dhe emocionet duhet të analizohen dhe studiohen si një ndër faktorët që ndikojnë në paraqitjen e sjelljeve kriminale.⁴⁶

2.9 Motivet

Janë cilësi dhe veti personaliteti. Motivet janë fuqitë nxitëse të cilat e shtyjnë një individ që të jetë aktiv, e orientojnë dhe e udheheqin aktivitetin e tij në jetë. Motivet, si veti të personalitetit, përbëhen prej elementeve të vetëdijes dhe të vullnetit. Për këtë arsye, në literaturën kriminologjike dhe psikologjike, thuhet se të gjitha aktivitetet njerëzore paraqiten dhe zhvillohen në bazë të elementeve të vetëdijes dhe të vullnetit, sepse, të gjitha janë të motivuara. Është e njohur që secili individ apo person normal, para se të ndërmarrë një veprim, sjellje dhe aksion, duhet të mendojë që të vendosë dhe të vihet në lëvizje nga disa shtytje dhe nxitje të brendshme. Këto veprime, te individët, janë të përbëra nga një varg procesesh që nxiten dhe shtyten nga forcat e brendshme që gjenden në sferën e vetëdijes dhe të vullnetit të tij. Pra, të gjitha sjelljet dhe veprimet e individëve, janë të motivuara. Çdo aktivitet i njeriut normal, është aktivitet i nxitur

⁴⁶Po aty, fq 331-333.

nga motivet, vetëdija dhe vullneti i tij. Njeriu, si qenie e vetëdijshme, nuk vepron vetvetiu, pa qenë i nxitur dhe i shtyrë nga disa procese dhe nevoja të brendshme. Ai nuk vepron në mënyrë automatike por gjithmonë në sjelljet dhe qëndrimet e veta udhëhiqet nga motivet e ndryshme. Kur flitet kështu për motivin dhe motivimin e sjelljeve të njeriut, gjithmonë kihet parasyshë njeriu dhe personaliteti normal. Te këta persona, është karakteristike se veprojnë në mënyrë të vetëdijshme, racionale, ndërsa personat me motive të çrregulluara reagojnë dhe veprojnë në mënyrë të pakuptueshme dhe në veprimet dhe sjelljet e tyre nuk vërehen motive të qarta. Për këtë arsye zakonisht personat e tillë kanë përgjegjësi të zvogëluar ose nuk përgjigjen fare.⁴⁷

2.10 PROFILI I KRYERËSVE TË VEPRAVE PENALE TË KUALIFIKUARA

Në kapitullin e radhës do të mundohem të shpjegoj profilin e kryerësve të veprave penale, pra tërësinë e tipareve themelore të personave kriminel, të cilat i dallojnë ato nga personat tjerë.

Si tipare të cilat ndikojnë në paraqitjen e këtij fenomeni janë: mosha, gjinia, përkatësia nacionale, profesioni. Tani do të mundohem të jap nga një pasqyrë më konkrete lidhur me studimin dhe analizën e disa veçorive themelore të këtij fenomeni.

Kriminaliteti, si dukuri mjaft komplekse, paraqet një fenomen që kërkon një angazhim të veçantë në hulumtimin dhe studimin e tij.

2.10.1. Mosha

Marrëdhënia midis moshës dhe krimit është një prej marrëdhënieve më të forta në të gjithë kriminologjinë. Kjo marrëdhënie tregon se krimi rritet në adoleshencë, rreth moshës 14 vjeç, majat i arrin në fillim të 20-tëve, dhe me pas kësaj.⁴⁸ Mosha është karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal. Mosha e kryerësve të veprave penale përkatesisht të sjelljeve kriminale, mund të ndahet sipas përcaktimeve ligjore positive. Sipas ligjeve positive të vendeve të

⁴⁷ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 334.

⁴⁸ <https://onlinelibrary.wiley.com/doi/pdf/10.1002/9781118519639.wbecpx275>

ndryshme, mosha e kryerësve ndahet në mosha të personave të mitur dhe personave të rritur. Brenda këtyre dy ndarjeve kryesore, kemi edhe ndarje të tjera. Mosha e mitur ndahet në të mitur të rinj, e cila përfshin moshën 14-16 vjet dhe në të mitur të rritur që përfshin moshën 16-18 vjet. Kategoria e personave deri në moshën 14-vjeçare, në literaturën kriminologjike dhe juridiko-penale trajtohet si moshë e fëmijëve dhe zakonisht personat e kësaj moshe nuk i nënshtrohen trajtimeve juridiko penale. Ndaj tyre, nëse kryejnë veprimet delikuede, zakonisht ndërmiren masa të kontrollit dhe mbikqyrjes nga ana e familjes dhe organeve të ndryshme të cilat merren me mbrojtjen e fëmijëve dhe me kujdes social. Mirëpo, në disa shtete, në këtë drejtim bëhen edhe përjashtime. Shpeshherë, në disa shtete të lindjes, mosha e personave prej 10-14 vjet i nënshtrohet përgjegjësisë së caktuar penale.

Si moshë e rritur konsiderohet mosha prej 18 e deri në vdekje të individit. Mirëpo pjesëmarrja në kriminalitetin e kësaj moshe, pra moshës së rritur, nuk është njësoj në të gjitha fazat e jetës së këtyre individëve. Në literaturën kriminologjike dhe në kërkimet praktike, ndarja dhe kategorizimi i moshave të personave të rritur zakonisht bëhet në dekada, p.sh. ndahen në faza prej 10 apo 20 vjetësh, apo edhe më pak. Kësisoj flitet për moshën e personave të rritur prej 18-25 vjet si moshë e veçantë, pastaj mosha prej 25-30, mosha 30-40, mosha 40-50, mosha 50-60 dhe, në fund mosha më e vjetër se 60. Nëse shikohen të dhënat statistikore, gjyqësore dhe të dhënat nga kërkimet empirike kriminologjike në botë, vërehet se moshat më prezente në veprimet kriminale janë mosha prej **25-30**, pastaj grupi i moshës **30-50** dhe më pak grupi i moshës mbi 60 vjet. Vlen të theksohet se edhe mosha prej 18-25 është mjaft prezente dhe kjo vlerësohet si një i ashtuquajtur kriminaliteti i të rinjëve i cili në botën bashkëkohore tregon karakteristika të veçanta, si për nga mënyra e kryerjes, ashtu edhe për kah intensiteti i paraqitjes në veprimet kriminale. Kësisoj mosha e re merr pjesë më shumë në kryerjen e krimeve kundër pasurisë si janë vjedhjet, vjedhjet me thyerje, plaçkitjet, trafiket ilegale me narkotikë, etj. Ndërsa të rriturit në krimet tjera duke filluar prej krimeve kundër jetës dhe trupit, dhunimet, krimi i organizuar, etj. Grupi i moshave 25-30 dhe 30-50, është grupi i popullatës më aktive në jetën e përditshme në çdo shoqëri. Këto grupe të moshave, më së shpeshti ballafaqohen me problem të llojllojshme të jetës së përditshme. Për këtë arsye, edhe ata vijnë në situatë që më së shpeshti kryejnë sjellje kriminale dhe të shkaktojnë konflikte të caktuara, të cilat sjellin kriminalitetin në shoqëri.⁴⁹ Për derisa jemi te mosha desha të theksoj që në aktgjykimin e marrë në Gjykatën Themelore të

⁴⁹ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 126-127.

Gostivarit i pandehuri me nacionalitet rom ka qenë i moshës 38 vjeçare. Nga shqyrtimi i lëndëve në Gjykatë vërejtja që është mosha më prezente edhe në veprimet kriminale të qytetit tonë është **30-50**.

2.10.2. Gjinia

Marrëdhëniet midis gjinisë dhe krimit janë të thella, këmbëngulëse dhe paradoksale. Gjinia është njohur si një nga faktorët më të rëndësishëm që luan një rol të rëndësishëm në trajtimin e llojeve të ndryshme të krimeve brenda sistemeve të drejtës penale. Prej kohësh është konsideruar që burrat dhe gratë ndryshojnë në shkallët dhe modelet e tyre të veprave penale dhe në përvojat e tyre të viktimizimit. Ekziston një përshtypje e përgjithshme, në bazë të të dhënave të statistikës kriminale dhe praktikës gjyqësore, se kriminaliteti është një dukuri tipike e gjinisë mashkullore. Sipas kërkimeve kriminologjike, nga literatura kriminologjike, të bëra në shumë vende të botës, deri në kohën më të re, gjinia mashkullore, përkatësisht kryerësi i veprave kriminale të gjinisë mashkullore, kanë dominuar në mënyrë absolute. Mirëpo tani, në shoqërinë bashkëkohore, gjendja ka ndryshuar dukshëm ngase femrat, gjithnjë e më tepër, po marrin pjesë në kryerjen e sjelljeve të llojllojshme kriminale.

Sipas statistikave botërore, përqindja e pjesëmarrjes në kriminalitet të përgjithshëm e personave të gjinisë femërore, sillet nga 8-10 % të të gjithë pjesëmarrësve.⁵⁰ Mirëpo, duhet theksuar se te disa sjellje kriminale dhe vepra penale pjesëmarrja e femrës është më e madhe. Karakteristika e kriminalitetit të femrave është edhe fakti se ato më tepër marrin pjesë në kryerjen e krimeve ndihmëse, shtytëse e më pak si kryerëse e drejtpërdrejtë apo organizatore të krimeve të caktuara.

Disa autorë, mendojnë se disa sjellje kriminale janë tipike femërore. Në këtë drejtim flitet për krimin e vrasjes së të posalindurit, pjesëmarrjen në prostitucion, mashtrimet dhe krimet tjera. Disa të tjerë theksojnë mënyrat dhe metodën e veçantë të kryerjes së krimeve nga personat e gjinisë femërore. Kësisoj, flitet për aftësinë e femrës për ta vënë në lajthim viktimën, për shfrytëzimin e vetive të saj fizike, për dinakërinë dhe për përdorimin e disa mjeteve të veçanta të kryerjes së veprave penale, etj. Me emancipimin dhe kyçjen gjithnjë e më të madhe të femrës në të gjitha sferat e jetës dhe të punës, vërehet edhe shtimi dhe rritja e pjesëmarrjes së saj në

⁵⁰Po aty, fq 131

aktivitetet kriminale. Kështu që, dukshëm vihen në pyetje disa konstatime të mëhershme teorike në kriminologji se gjoja kriminaliteti është dukuri tipike e meshkujve dhe se femrat për shkak të konstitucionit të tyre biofizik dhe biopsikik, objektivist, kryejnë më pak krime.⁵¹ Në bazë të statistikave të marra nga Enti Shtetëror i Statistikës së Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë vitit 2017 janë regjistruar gjithsej 19 779 kryerës të veprave penale ku 18575 prej tyre të gjinisë mashkullore, dhe 1204 të gjinisë femërore. Siç shihet se edhe gjatë këtij viti dominon në veprimet kriminale gjinia mashkullore. Ku prej tyre 5 109 janë maqedonas, 2 436 janë shqiptarë, 311 turq, 701 janë rom, 53 srb, 69 Boshnjak dhe tjerët nuk dihen se cilit nacionaliteti i përkasin. Sa i përket gjinisë femërore 717 janë maqedonase, 82 shqiptare, 25 turke, 5 sërbe, dhe të tjerat nuk dihen.⁵²

2.10.3. Profesioni dhe kriminaliteti

Profesioni apo mjeshtëria, gjithashtu konsiderohet si faktor që ndikon në paraqitjen e kriminalitetit. Disa autorë kanë menduar se disa lloje të profesioneve dhe mjeshtërive paraqiten si faktorë të drejtpërdrejtë të sjelljes kriminale. Këtë pohim të tyre, janë përpjekur ta arsyetojnë me të madhe dhe fakte nga praktika gjyqësore dhe literatura e pasur kriminale. Ata theksojnë se disa persona që u përkasin disa mjeshtërive dhe zanateve, më shpesh paraqiten si kryerës të disa sjelljeve kriminale, se sa personat e profesioneve të tjera. Kjo shpjegohet me faktin se, këtyre personave, vetë mjeshtria-profesioni, ua lehtëson kryerjen e disa formave të kriminalitetit dhe ata në këtë mënyrë mund të kryejnë krimin pa vështirësi. Poashtu, këtyre personave, profesioni u mundëson që gjurmët e krimit të tyre t'i fshehin më lehtë se sa personat e profesioneve të tjera. Kriminologu i njohur Ernest Selig, në veprën e vet “Traite de Criminologie” thekson se profesioni apo mjeshtria vetvetiu nuk e krijon një njeri si kriminel dhe si delikuent, nëse ai vërtet nuk është i prirur të kryejë sjellje kriminale ose nëse në të nuk ndikojnë rrethana dhe shkaqe tjera. Profesioni nuk e krijon kriminalitetin. Megjithatë, në jetën e përditshme vërehen disa dukuri që pak a shumë flasin për pjesëmarrjen më të madhe në kryerjen e disa sjelljeve kriminale, të personave që u përkasin profesioneve apo mjeshtërive të caktuara. Me të drejtë, në literaturën

⁵¹Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 128-129.

⁵²<http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=43>

kriminologjike theksohet se vetë profesioni apo mjeshtria, nuk krijon kriminel por atyre u ofron kushte më të volitshme me mundësi më të madhe për kryerjen e krimeve në mënyrë më të lehtë, sesa personave të mjeshtrove dhe profesioneve të tjera.⁵³

2.10.4. Arsimi

Arsimi është një faktor me rëndësi në formimin dhe aftësimin e personalitetit të njeriut për jetë më të sigurt dhe më të suksesshme. Një kohë të gjatë është menduar se arsimimi është një mjet mjaft i fuqishëm për pengimin e sjelljeve devijante dhe kriminale. Personat e arsimuar, me vështirësi mund të bien në ndikime negative. Ata janë të paisur me dije dhe informata të shumta dhe e kanë më lehtë të marrin qëndrime dhe sjellje positive. Për këtë arsye, është theksuar se, personat e arsimuar, gati gjithherë sillen në pajtim me normat ligjore dhe morale të një shoqërie. Në këtë drejtim, në literaturën e mëhershme kriminologjike, dukurisë së kriminalitetit dhe raportit të tij me arsimimin i është kushtuar rëndësi e veçantë, janë bërë kërkime empirike dhe studime të shumta të raporteve të ndryshme në mes të arsimimit dhe sjelljeve kriminale të individëve të caktuar. Mendimin optimist veçmas e ka mbrojtur autori i njohur Enriko Feri, i cili në hulumtimet dhe studimet e veta, thekson se kriminaliteti zvogëlohet në shoqëri krahas rritjes së shkallës së arsimimit të popullatës. Në veçanti thekson se emancipimi dhe civilizimi i popullatës ndikon në rënien e kriminalitetit. Personat e arsimuar më pak merren me veprime dhe sjellje kriminale sepse, si thuhet, kanë aftësi të gjykojnë për pasojat dhe dënimet që u sjellin veprimet eventuale kriminale. Nga ana tjetër, personat e paarsimuar më vështirë mund të kyçen në shumë procese jetësore, atyre u mungon aftësia për t'i kuptuar dhe gjykuar drejt pasojat e veprimeve të ndryshme, për çka ata nuk janë të aftë t'u bëjnë rezistencë nxitjeve dhe sprovave të ndryshme të ambientit shoqëror. Shpeshherë, në literaturën kriminologjike, për t'u dëshmuar roli dhe rëndësia që ka arsimimi dhe dijenia përmendet një mendim i shkrimtarit të madh francez, Viktor Ygos “ Hapja e një shkolle do të thotë mbyllja e një burgu”.

Pa marrë parasysh pikëpamjet e ndryshme që u prezentuan, është një e vërtetë e pamohueshme, se të dhënat e ndryshme të statistikave gjyqësore, të shumë vendeve, tregojnë se pjesëmarrja e personave të paarsimuar ose me shkallë të ulët të arsimit është e madhe në kryerjen e sjelljeve kriminale në shumë vende të botës. Ky konstatim veçmas ka të bëjë me kryerjen e disa veprimeve kriminale, si: vepra penale kundër jetës dhe trupit, kundër pronës, sjelljet dhe krimet e

⁵³ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 242.

dhunës etj. Këtë konstatim e vërtetojnë edhe hulumtimet dhe kërkimet empirike që janë bërë në shumë vende të botës. Në botën bashkëkohore, në kryerjen e disa sjelljeve kriminale po rritet pjesëmarrja e personave me arsim të lartë. Kryerësit e veprave penale të kriminalitetit ekonomik, kriminalitetit politik, kriminalitetit të organizuar, kriminalitetit të jakës së bardhë dhe kriminalitetit profesional, në të shumtën e rasteve janë persona të arsimuar, persona të cilët kanë njohuri dhe përgatitje profesionale të gjithanshme ekonomike, finansiare dhe politike. Këta persona, veçmas kanë njohuri lidhur me sistemet e komplikuar teknike teknologjike. Ata, kanë njohuri të gjëra dhe me lehtësi e aftësi të veçanta përdorin teknikën e kompjuterëve dhe përcjellin lëvizjet në ekonomi, në banka dhe në bursa tregtare. Prandaj ata kyçen me lehtësi në kryerjen e transakcioneve të ndryshme financiare kriminale dhe po ashtu me lehtësi arrijnë t'i shmangen kapjes nga policia apo daljes në gjyq për veprime të tilla. Nga kjo del se nuk mund të flitet në mënyrë të përgjithësuar që arsimimi pengon kriminalitetin apo e nxit atë. Për këtë arsye, ndikimin e arsimimit në sjelljet e ndryshme kriminale duhet shikuar nga aspekti relativ e jo të përgjithësohet ky faktor. Kur pohoet kështu, në rend të parë mendohet për faktin e pamohueshëm në disa forma të kriminalitetit, shikuar praktikën gjyqësore, i kryejnë personat e paarsimuar. Nga ana tjetër disa veprime kriminale, gjithashtu bazuar në të dhënat statistikore, i kryejnë personat me arsimim të lartë.

2.11. Recidivizmi

Kur jemi në këtë kapitull duhet përmendur edhe recidivizmin i cili ndikon në profilin e kryerësve të veprave penale. Recidivizmi ose përsëritja e sjelljeve kriminale, paraqet një formë të veçantë të manifestimit të kriminalitetit, që në vete ndërlidh rrezikshmëri të posaçme shoqërore. Në kushtet bashkëkohore, kjo formë e kriminalitetit paraqet një problem të veçantë, të cilit i kushtohet kujdes në teorinë juridiko-penale, ashtu edhe në atë kriminologjike. Problematika e përsëritjes së kriminalitetit, ka qenë objekt trajtimi në shumë tubime shkencore ndërkombëtare. Kësisoj, këtë çështje e ka trajtuar Kongresi i III-të ndërkombëtar për Kriminologji, në Londër, në vitin 1955. Poashtu, edhe Kongresi i III-të ndërkombëtar i Kombeve të Bashkuara në Stokoholm, në vitin 1965, ka trajtuar problemin e recidivizmit.⁵⁴ Sipas kuptimit juridiko-penal me recidivisëm nënkuptojmë kryerjen e përsëritur të veprave penale nga ana e një

⁵⁴ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 229.

personi i cili ka qenë më parë i dënuar për ndonjë vepër penale. Kjo pikëpamje mbi recidivizmin nisët nga kriteret formale juridike, duke marrë parasysh faktin se kryerësi i veprës penale pas aktgjykimit të plotfuqishëm kryen përsëri vepra penale.⁵⁵ Ndërsa sipas kuptimit kriminologjik, recidivizmi nënkupton përsëritjen e sjelljeve kriminale dhe delikumente të një personi pa marrë parasysh se a ekziston më parë gjykimi i plotfuqishëm, ose pa marrë parasysh se a është mbajtur dënimi për veprat e mëparshme penale. Sipas kuptimit penologjik, me recidivizëm nënkuptojmë ardhjen e sërishme të kryerësit të veprës penale në entet ndëshkimore-përmirësuese apo edukativo-përmirësuese. Pra, këtu kemi të bëjmë me persona të cilët në institucionin ndëshkivor përmirësues apo edukativo-përmirësues vijnë dy e më tepër herë për shkak të përsëritjes së veprave penale.⁵⁶ Sa i përket faktorëve që ndikojnë në paraqitjen e recidivizmit ato mund të jenë të natyrës objektive dhe subjektive. Vetë fakti se personat recidivistë përsërisin disa herë veprën penale, vetë fakti se dënimet dhe masat e aplikuara ndaj tyre nuk kanë dhënë rezultate në drejtim të përmirësimit dhe risocializimit të tyre, parashtron nevojën e theksimit të disa faktorëve të veçantë subjektiv që ndikojnë në veprimet dhe sjelljet e tyre kriminale. Këta faktorë, shpeshherë lidhen me disa veti dhe shprehje të natyrës individuale dhe subjektive, me të ashtuquajtur faktorë të brendshëm të sjelljes kriminale. Në këtë drejtim, në literaturë përmenden edhe faktorët e jashtëm që ndikojnë në sjelljet kriminale të recidivistëve. Këto janë rrethanat joadekuate familjare, konfliktet në familje, varfëria, papunësia, konsumimi i alkoolit dhe drogës etj. Posaçërisht si faktor i jashtëm, nga disa autorë përmendet edhe ndikimi negativ i qëndrimit në burgje dhe ente ndëshkimore-përmirësuese.⁵⁷

⁵⁵ Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, fq 229.

⁵⁶ Po aty, fq 230.

⁵⁷ Po aty, fq 231.

KAPITULLI III

3.DËNIMET NË BAZË TË TIPOLOGJISË SË VRASJEVE TË KUALIFIKUARA

Sanksionet penale janë masa të dhunshme penalo-juridike të cilat i shqipton gjykata në procedurën e përcaktuar në ligj ndaj kryerësit të veprës penale, me qëllim të mbrojtjes së shoqërisë dhe individit nga kriminaliteti, ndërsa konsistojnë në marrjen apo kufizimin e lirive dhe të drejtave të caktuara apo në tërheqjen e vërejtjes kryerësit se do t'i merren apo kufizohen liritë apo të drejtat nëse sërish kryen veprë penale.

3.1 Dënimet kryesore

Dënimet kryesore shqiptohen ndaj personave madhor, të cilët janë penalisht të përgjegjshëm për veprën penale të kryer. Nga kjo del se që të mund t'i shqiptohet dënimi si një lloj i sanksionit penal, personi duhet të jetë pikërisht i shëndoshë (të ketë kuptuar rëndësinë e veprës së vet dhe të ketë pasur aftësi t'i kontrollojë sjelljet e veta) dhe që veprën penale ta ketë kryer me fajin e tij (me dashje apo nga pakujdesia).Për nga brendia dhe natyra e tyre, në tërësisht të sanksioneve penale dënimet kryesore janë qortim socialo-etik të intensitetit të lartë, me të cilat kryerësit të veprës penale i merren apo i kufizohen liritë dhe të drejtat e rëndësishme.

Burgimi—pra dënimet me burg janë sanksione penale të cilat, në shtetet bashkëkohore, aplikohen më së shumti në praktikën gjyqësore. Këto dënime zënë vend qëndror në sistemin e sanksioneve penale. Trajtimi dhe studimi i dënimeve me burgim, bëhet lëndë kryesore e penologjisë bashkëkohore.Mirëpo, dënimet me burgim kanë pasur një histori të gjatë të zhvillimit dhe të transformimit.Ato kanë kaluar një rrugë interesante evolutive.Paraqitja e dënimeve me burgim, fillon që nga koha e burgjeve të para e deri te dënimet bashkëkohore me burgim.

Burgosja dhe privimi nga liria, i kryerësve të veprave penale dhe personave të tjerë që sillëshin në mënyrë devijante, paraqitet shumë më herët se sa paraparja formale e dënimit me burgim si denim.. Pra, paraqitja e burgjeve të para nuk përputhet me sanksionimin e dënimeve

me burgim, sepse këto paraqiten më vonë.⁵⁸ Burimet historike flasin se e drejta e shteteve të lashta si e drejta kineze, e drejta asirase, e drejta egjiptase dhe të drejtat tjera e kanë njohur burgun.⁵⁹

Sa i përket aspektik historik, në Greqinë dhe Romën e vjetër dhe në disa shtete mesjetare, gjithashtu kanë ekzistuar burgje. Kësisoj këto burgje kanë qenë të vendosura në kështjella të vjetra ‘Bastilles’, ose në bodrumet e kalave ‘Qubliettes’, të cilat kanë qenë të braktisura, ndërsa kushtet e qëndrimit kanë qenë shumë të rënda dhe të vështira. Në këto burgje qëndronin persona të cilët kishin kryer sjellje të ndryshme delikuede, sidomos vjedhësit dhe bredhësit. Në literaturë theksohet se në këto burgje, veçmas në kohën e mesjetës, dërgoheshin persona të dyshimtë, në bazë të urdhëresave sekrete të mbretërve që në Francë njiheshin me emrin “Lettre de cachet”. Këto burgje kanë shërbyer si masë preventive ndaj një kategorie të delikuentëve, ndërsa ndaj të tjerëve këto burgje kanë shërbyer vetëm si qëndrim i përkohshëm deri sa mbahet gjykimi dhe të shqiptohet dënim kryesor. Në Romën e vjetër, ka qenë i njohur burgu “Tullanium” ku mbaheshin personat e dyshimtë derisa u shqiptohet denimi kryesor.⁶⁰

Nga shqyrtimet e paraqitura del se burgimi si formë e heqjes së lirisë dhe mjet i mbrojtjes nga kriminaliteti, ka kaluar nëpër dy faza kryesore: nëpërmjet fazës preventive dhe fazës së dënimit si mjet dhe sanksion penale. Burgimi si mjet preventivë, siç u pa, ka pasur disa forma të veta. Në fillim është trajtuar si paraburgim, derisa nuk është shqiptuar dënim kryesor. Pra, në këtë fazë, ishte një farë burgu hetues derisa nuk përfundonte trajtimi dhe shqyrtimi i çështjes nga gjykata, më vonë, burgu aplikohet si një lloj mase e veçantë administrative, si një lloj mase profilatike, si burg policor ndaj kategorve të caktuara të delikuentëve dhe qytetarëve problematikë, sidomos ndaj endacakëve, lypësve të papunëve, alkoolistëve dhe prostitutave. Qëllimi i kësaj mase ishte që për një kohë të shkurtër, nga ambient i caktuar të mënjanohen personat delikuentë dhe përkohësisht të vendosen në ente-burgje të veçanta. Në disa raste, burgimi ndërmerrej edhe si masë e ndalimit të kryerësit të veprës penale derisa ai ti kryente obligimet fiskale dhe material ndaj shtetit ose personave të tjerë, posa ti kryente ato obligime ai lirohej nga burgu. Këto ishin format më të shpeshta të burgimit apo heqjes së lirisë, të cilat nuk mund të trajtohen si dënim i vërtetë me heqje lirie. Dënimi i vërtetë me burgim paraqitet më vonë,

⁵⁸ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 93.

⁵⁹ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 93.

⁶⁰ Po aty, fq 93.

pas ndryshimeve të mëdha të cilat bëhen në shoqëri dhe pas depërtimeve të ideve dhe mendimeve përparimtare lidhur me luftimin e kriminalitetit.⁶¹

Faktorët themelorëqë kanë kontribuar në paraqitjen e dënimit me burgim janë:

1. Mendimet dhe idetë humaniste e përparimtare të filozofëve dhe shkollave të ndryshme
2. Idetë dhe kontributi i Revolucionit francez dhe legjislacioni i tij penal dhe ndikimi i pranisë së lirive dhe të drejtave të qytetarëve
3. Shfrytëzimi i punës së personave të dënuar si fuqi e lirë punëtore

1.Mendimet dhe idetë humaniste e përparimtare lidhur me shkaqet e kriminalitetit e veçmas me politikën ndëshkimore dhe nevojën e reformimit të burgjeve paraqiten qysh herët, në punimet dhe veprat e filozofëve dhe mendimtarëve të mirënjohur, si: T.Mor, H.Grocus, ZH.Ruso, C.Bekarie, XH.Huard etj. Këta, në mënyrë sistematike dhe të ashpër, kanë kritikuar politikën dhe sistemin ndëshkivor dhe gjendjen e burgjeve në shoqërinëfeudale e sidomos aplikimin e dënimeve me vdekje, torturave fizike dhe format tjera tëndëshkimit degradues. Në punimet dhe trajtimet e tyre filozofike, ata kanë propozuar që këto dënime barbare dhe çnjerzore të zëvendësohen me dënime me burgim. Po ashtu ata janë angazhuar që personat e dënuar të kyçen në procesin e punës me qëllim të përmirësimit të tyre. Sipas tyre, hakmarrja nuk duhet të jetë si qëllim vetëm i dënimit, por dënimi duhet të ndikojë në përmirësimin dhe riedukimin e tyre. Mirëpo, këto ide, edhe pse u paraqiten në shoqërinë feudale, nuk arritën të realizohen në atë kohë. Ato u realizuan vetëm në kushtet që u krijuan pas Revolucionit borgjes francez.⁶²

2.Revolucioni francez sjell nderrime rrënjësore të bazës juridike dhe shoqërore të së drejtës penale dhe të sistemit ndëshkivor. Ai ndikoi në nxjerrjen e një varg ligjesh të reja ku parashikohen dënimet me burgim si dënime kryesore për një varg veprash penale, për të cilat më parë zakonisht shqiptohej vetëm dënimi me vdekje apo dënimet me tortura fizike. Tani dalin në pah parimet e njohura të shkollave dhe lëvizjeve humaniste historiko-juridike, si p.sh: parimi i ligjshmërisë, i cili shprehej në rregullën ‘nullum

⁶¹ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 96.

⁶² Po aty, fq 96-97.

crimen sine lege, nula poena sine lege', parimi i barazisë qytetare me burgim konsiderohet edhe fakti se tani në shoqërinë e re, jeta e njeriut, liritë dhe të drejtat e qytetarëve fitojnë një cilësi dhe kualitet të veçantë dhe proklamohen si vlera më të mëdha të cilat duhet të mbrohen, ruhen dhe të respektohen. E drejta për jetë, e drejta për liri, e drejta e pronës, e drejta e mendimit të lirë dhe e drejta e qarkullimit, konsiderohen dhe bëhen vlera më të mëdha. Këto qëndrime, ndikuan në masë të madhe që të bëhet reduktimi i disa dënimeve të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë cënonin këto liri dhe tëdrejta. Në këtë mënyrë, zëvendësohen dënimet me vdekje, dënimet fizike, torturat fizike, dënimet morale dhe çnjerëzore me dënim me burgim.⁶³

3.Fuqia e lirë punëtore e personave të dënuar dhe dëshira e shoqërisë borgjeze që të përfitojë kapital ishte një ndër arsytet e paraqitjes së dënimeve me burgim. Dihet se shoqëria borgjeze, si shoqëri e re, fillon një proces të zhvillimit dhe të ekspansionit ekonomik e industrial dhe se në fazën e parë të saj i duhej fuqi e madhe punëtore, e sidomos fuqi e lirë punëtore. Duke u nisur nga ky interes, pushteti ishte i interesuar që ndaj personave të dënuar mos të aplikoheshin më tej dënimet me vdekje dhe dënimet e tortura fizike, por dënimet me burgim, ngase në këtë mënyrë ekziston mundësia e shfrytëzimit të tyre për punë në industri dhe në punë të tjera publike. Kësisoj, personat e dënuar, duke u kyçur në punë publike apo punë të ndërmarrjeve të ndryshme, në një mënyrë zhdëmtonin dhe kompensonin dënimin ndaj shoqërisë, për krimet e kryera. Në literaturë përmenden dukuritë dhe rastet e shfrytëzimit të punës së personave të dënuar në industri, në manifaktura, në plazhe dhe në sektore të tjera, ku të dënuarit me heqje të lirisë punonin punë të rënda fizike. Kjo punë ishte mjaft e vështirë dhe e rëndë, personat e tillë të dënuar nuk kishin kurrfarë shpërblimi për punë. Ky sistem i angazhimit të personave të dënuar në punë fizike është kritikuar si johuman dhe i vrazhdë. Por, sido që të jetë, ai ka qenë faktor që ka ndikuar në paraqitjen dhe zbatimin e dënimit me heqje të lirisë.⁶⁴

Në vijim do të flasim për sistemet kryesore të ekzekutimit të dënimit me burgim dhe llojet e tyre. Paraqitja e dënimeve me burgim ka qenë një hap i madh drejt humanizmit të reagimit të shoqërisë ndaj kriminalitetit e sidomos të tretmanit ndaj personave të dënuar.

⁶³ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 97.

⁶⁴ Po aty, fq 98.

Nëse shikohet me kujdes rruga e zhvillimit të dënimeve me burgim, që nga burgjet e para e deri te entet bashkëkohore, do të vërehet se nëpërmes mënyrës së ekzekutimit dhe trajtimit të personave të dënuar, është shprehur filozofia retributive apo ajo e përmirësimit dhe riintegrit. Në fillim, dënimet shikuar për nga numri, llojet dhe mënyra e ekzekutimit, kishin kryekëput qëllimin e hakmarrjes, shpagimit dhe shkaktimit të vuajtjeve personave të dënuar e shumë pak kanë pasur qëllime tjera. Ndërsa, më vonë, me depërtimin e ideve humanitare shkencore, dënimi me burgim synon përmirësimin dhe riintegritin e personave të dënuar. Disa autorë mendojnë se ekzistojnë shumë sisteme, disa të tjerë ato i përqëndrojnë vetëm në tri apo katër. Mirëpo, sido që të jetë, do të paraqiten të gjitha ato sisteme dhe metoda të ekzekutimit të dënimit me burgim të cilat në mënyrë kronologjike, historike, janë lajmëruar prej momentit të paraqitjes të dënimit me burgim e deri në ditët e sotme.⁶⁵

Sistemi iburgut kolektiv, sipas këtij nuk ka klasifikim të të dënuarve, ndodh që së bashku dënimin ta mbajnë të dënuarit për krime të rënda, recidivistët, personat me karrierë të gjatë kriminale, personat e vjetër me të miturit, kryerësit primar me kryerësit sekondarë, etj. Si lokale për ekzekutimin e dënimeve me burgim, gjatë aplikimit të këtij sistemi, në fillim shërbenin: bodrumet dhe lokalet e braktisura të fortesave, kështjellave, kalave dhe objekteve të vjetra ku kushtet e jetës ishin shumë të rënda. Kushtet higjienike dhe shëndetësore në këto burgje e ente ishin të mjerueshme. Për këtë arsye, shpeshherë, këto burgje ishin vatër e përhapjes së sëmundjeve të rënda ngjitëse. Me gjithë faktin se inaugurimi i dënimit me burgim dhe paraqitja e një sistemi të këtillë, në fillim dukej si një hap pozitiv dhe si metodë humane në luftimin e kriminalitetit, sidomos kur ajo krahasohej me kohën e dominimit të dënimeve me vdekje, dënimeve trupore dhe torturave fizike, prapëseprapë, mënyra e këtillë e ekzekutimit të dënimit, edhe më tej ka qenë e përcjellë me një varg të metash dhe dobësish. Entet dhe burgjet e këtilla ku mbahej dënimi me burgim, ishte në një nivel shumë të ulët dhe të mjerueshëm të kushteve jetësore higjienike dhe shëndetësore. Të dënuarit në këto ente, në shumë raste kanë qenë të maltretuar dhe të nënshtruar ndaj keqtrajtimeve dhe rrahjeve nga ana e gardianëve dhe personelit tjetër të burgut. Në këto burgje, shpeshherë ishin të pranishme

⁶⁵ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 101-102.

dukuri dhe sjellje të ndryshme patologjike dhe negative si: prostitucioni, bixhozi, mashtrimet, vrasjet dhe veprimet tjera të rrezikshme.⁶⁶

Sistemi i izolimit ose i qelisë është sistemi i parë që është rregulluar në mënyrë normative juridike. Vetëm me inaugurimin e këtij sistemi, shteti fillon që në mënyrë të organizuar ta zbatojë dhe ekzekutojë dënimin me burgim dhe të marrë vetë përgjegjësinë për zbatimin në jetë. Ky sistem quhet ndryshe edhe sistemi pensilvanik apo filadelfik, për arsye se sistemi i izolimit apo i qelisë, për herë të parë është paraqitur në qytetin Filadelfia, të shtetit të Pensilvanisë në SHBA, në vitin 1790. Për herë të parë këtë sistem e kanë predikuar besimtarët e një sekte protestante, të sektës kuekere, ku sipas pikëpamjeve të tyre personi i dënuar, duke qëndruar i izoluar dhe i vetmuar, ka kohë të mendojë për veprën dhe sjelljet e tij kriminale, me qëllim që ti jepet shansi për tu penduar për veprimet kriminale dhe për tu përmirësuar në pikëpamje morale. Pra sipas këtyre pikëpamjeve, të gjithë të dënuarit duhet të vendosen nëpër kthina të veçanta, nëpër qeli, dhe të qëndrojnë të vetmuar një kohë të caktuar dhe në këtë mënyrë të pendohen për krimin që kanë bërë.⁶⁷

Sistemi i heshtjes sipas këtij sistemi, personat e dënuar natën, qëndrojnë të ndarë nga njëri-tjetri dhe të izoluar plotësisht, ndërsa, gjatë ditës, ata dërgohen në punë dhe aty u jepet mundësia të dalin nga izolimi, të punojnë së bashku me të dënuarit e të tjerë. Mirpo, gjatë kohës së punës dhe shkuarje-ardhjes në punë, ata e kanë pasur të ndaluar çdo bisedë dhe komunikim. Mosrespektimi i ndalesës së komunikimit dhe obligimit të heshtjes, është dënuar në mënyrë rigoroze nga personeli i institucionit. Për këtë arsye, ky sistem e ka marrë emrin sistemi i heshtjes ose silent system, sepse personat e dënuar kanë qenë të detyruar të heshtin tërë kohën sa kanë qëndruar së bashku. Njeriu, si qenie e vetëdijshme sociale, komunikimin me të tjerët e ka si pjesë të pandarë të jetës dhe formimit të tij. Kështu që, zhveshja nga kjo e drejtë natyrore, paraqet një goditje të rëndë për dinjitetin dhe personalitetin e të dënuarit. Për këtë arsye, shpeshherë, të dënuarit nuk kanë mundur të rezervohen e të mos komunikojnë, a janë dënuar në mënyra të vrazhda, me rrahje dhe tortura të ndryshme fizike dhe me kufizimin e disa të drejtave elementare.⁶⁸

⁶⁶ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 102-103

⁶⁷ Po aty, fq 105.

⁶⁸ Po aty, fq 108-109.

Sistemi progresiv në paraqitjen e këtyre sistemeve rëndësi të madhe kanë pasur themelimi dhe puna e disa shoqatave dhe asociacioneve profesionale të cilat merreshin me organizimin e institucioneve ndëshkimore dhe trajtimin e pozitës së personave të dënuar. Karakteristika themelore e këtij sistemi qëndron në faktin se personi i dënuar gjatë mbajtjes së dënimit me burgim, prej momentit të ardhjes në ent e deri sa të dalë në liri, ka mundësi që të ndërrojë pozitën e vet dhe atë në mënyrë graduale, varësisht prej angazhimit në punë dhe sjelljes së tij. Ai gjatë mbajtjes së dënimit, kalon nëpër disa faza në mënyrë progresive duke ndryshuar poziten e vet.⁶⁹

Sistemi progresiv anglez sipas këtij lloji sistemi, gjatë ekzekutimit të dënimit me burgim, të dënuarit kalojnë nëpër 3 faza kryesore:

Faza e parë mbajtjes së dënimit me burgim, sipas këtij sistemi, është faza e qëndrimit në qeli, përkatësisht faza e izolimit të personave të dënuar në vetmi. Në këtë fazë, të dënuarit mbylleen në qeli nuk kanë kurrfarë kontakti me të burgosurit tjerë e as me botën e jashtme.

Faza e dytë në këtë fazë, personat e dënuar gjatë ditës, punojnë së bashku me personat e tjerë të dënuar, pa obligim të heshtjes. Të dënuarit lirisht mund të komunikojnë lirisht gjatë procesit të punës, ndërsa natën, të dënuarit qëndrojnë izoluar në qeli të veçanta.

Faza e tretë e këtij sistemi qëndron në lëshimin me kusht të dënuar. Kjo do të thotë që personat e dënuar tani lirohen para kohe dhe dalin në liri pa mbajtur tërë dënimin e paraparë sipas vendimit gjyqësor.⁷⁰

Sistemi progresiv irlandez përkrah parimin e shkallëzimit të ekzekutimit të dënimit me burgim nëpër disa faza apo stadione. Sipas këtij sistemi, personat e dënuar duhet të kalojnë nëpër fazën e qelisë, fazën e burgut të përbashkët, fazën e qëndrimit në paralele për të lirë dhe fazën e lëshimit me kusht në liri. Mendimtari W.Grofton propozon që personat e dënuar, të cilët e mbajnë dënimin, para se të lirohen me kusht duhet të vendosen në një objekt të

⁶⁹ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 109-110.

⁷⁰ Po aty, fq 111-112.

veçantë ku kushtet e jetës dhe punës janë krejtësisht tjera nga ato të personave që gjenden në fazën e burgut të përbashkët.⁷¹

Sistemi i pikëve është një sistem interesant për disa risi dhe parime të cilat i ka aplikuar lidhur me tretmanin e personave të dënuar. Këtë sistem të ekzekutimit të dënimit me burgim, për herë të parë e aplikoi drejtori i entit ndëshkimor në ujdhesën Norfolk, kapiteni i marinës angleze Aleksandar Makonak, në vitin 1840.

Faza e parë të dënuarit kanë qenë të detyruar të punojnë. Janë kuçur në procesin e punës por puna ka qenë shumë e rëndë dhe detyrimet lidhur me respektimin e rendit shtëpiak kanë qenë rigorozë. Personat e dënuar, në këtë fazë, nuk kanë pasur kurrfarë favorizimesh, shpeshherë janë ndëshkuar në mënyrë të ashpër për shkeljet e detyrimeve dhe shkaktimin e ekscesive më të vogla.

Faza e dytë personave të dënuar u mundësohej të ndahen në grupe punë. Këto grupe ishin të vogla, nga pesë-gjashtë të dënuar. Personave të dënuar u mundësohej që vetë të bënin formimin dhe zgjedhjen e grupit të punës. Për secilin grup të të dënuarve, caktohej numri i poenave që duhej të përmbushej.

Faza e tretë grupi i të dënuarve shpërndahej dhe secili person i dënuar tani fitonte një shtëpizë të veten me një sipërfaqe të caktuar të tokës, ku ai mund të mirrej me punë bujqesore duke kultivuar prodhime të ndryshme.⁷²

Sistemi i klasifikimit ose i Gjenevës quhet sistem i Gjenevës për arsye se për herë të parë u aplikua në Gjenevë të Zvicrës, ndërsa cilësohet i klasifikimit, ngase këtu u vërejt një përpjekje më serioze dhe më e organizuar për ndarjen dhe klasifikimin e personave të dënuar në grupe, nëngrupe, klasë paralele, me qëllim të riedukimit dhe përmirësimit më të suksesshëm.

Faza e parë është gati identike në fazën e njëjtë në sistemin progresiv anglez. Personat e dënuar duhet ta kalojnë një kohë të mbajtjes së dënimit në qeli të izoluar dhe me një tretman të veçantë.

⁷¹ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 113

⁷² Po aty, fq 114-116.

Faza e dytë është më interesante. Në këtë fazë, personat e dënuar ndahen dhe klasifikohen në grupe, nëngrupe, klasë dhe paralele. Kjo ndarje apo ky klasifikim bëhet në bazë të kriterëve dhe rrethanave të ndryshme. Në fillim, më tepër në bazë të kriterëve objektive, e më vonë edhe në bazë të kriterëve subjektive.

Faza e tretë ka pasur të bëjë me lirim të personave të dënuar para kohe. Fjala është për lirim me kusht të personave të dënuar të cilës me sukses i kanë kapërcyer të gjitha sprovat e fazave të mëparshme dhe tani vlerohet se ata janë përmirësuar dhe nuk ka rrezik që të përsërisin veprën penale.⁷³

Sistemi modern ose bashkëkohor në paraqitjen e këtij sistemi ndikim të madh kanë pasur të arriturat shkencore nga lëmi i kriminologjisë, i së drejtës penale, i psikologjisë dhe penologjisë. Qysh më herët, drejtimet dhe shkollat e njohura kanë insistuar në aplikimin e njohurive shkencore gjatë ekzekutimit të dënimeve me burgim. Për t'u mbrojtur nga kriminaliteti, shoqëria duhet që patjetër, sipas sistemit modern, t'i klasifikojë personat e dënuar. Ndaj personave të dënuar që kanë treguar rrezikshmëri të veçantë, ndaj recidivistëve dhe ndaj të dënuarve të papërmirësueshëm, duhet aplikuar një terapi dhe tretman i veçantë.

Faza e parë sipas sistemit modern, fillon me vrojtimin dhe studimin e personit të dënuar. Personi i dënuar gjatë kësaj faze, i nënshtrohet një studimi dhe analize të një ekipi të ekspertëve të lëmenjëve të ndryshëm shkencor, pra duke aplikuar njohuritë shkencore nga lëmia e psikologjisë, sociologjisë, kriminologjisë, pedagogjisë dhe disiplinave të tjera, bëhet një njohje e tërësishme e personalitetit të dënuarit.

Faza e dytë është më e gërshetuar me një klasifikim të gjerë të personave të dënuar. Në rend të parë insistohet që gjatë klasifikimit të personave të dënuar të vijnë në shprehje vetitë personale të cilat janë të rëndësishme për procesin e riedukimit dhe riintegrit. Gjatë fazës së mbajtjes së përbashkët të dënimit, personi i dënuar kalon nëpër disa stadione. Personat e dënuar sikurse edhe në sistemin progresiv, edhe tani mund të ndikojnë dukshëm në përmirësimin e pozitës së tyre në ent.

⁷³ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 117-118.

Faza e tretë është lëshimi me kusht dhe ndihma postpenale ndaj të dënuarve. Lëshimi me kusht, sipas këtij sistemi, është mjaft i ngjajshëm me sistemin progresiv irlandez. E vetmja risi në sistemin modern qëndron në faktin se tani, personave të dënuar të cilët lëshohen me kusht, u ofrohet një ndihmë dhe kujdes i veçantë, që ka të bëjë me sigurimin e punës, sigurimin e vendosjes, mbrojtjen shëndetësore dhe ndihma tjera të cilat kanë për qëllim stabilizimin e tyre dhe pengimin e përsëritjes së sjelljës kriminale.⁷⁴

3.2 Dënimi me burgim sipas Kodit penal të Republikës së Maqedonisë së Veriut

Burgimi nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë, as më i gjatë se 20 vjet. Për veprat penale për të cilët është paraparë edhe dënim me burgim të përjetshëm, mund të shqiptohet dënim me burgim afatgjatë prej 40 vjet. Nëse për veprën penale të kryer me dashje është paraparë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 vjetësh, për formë të rënda të asaj vepre mund të caktohet edhe burgimi i përjetshëm. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund të caktohet si dënim i vetëm kryesor. Dënimi me burgim të përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet kryerësit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka mbushur 21 vjet të jetës. Burgimi shqiptohet në vite dhe muaj të plotë, kurse deri në 6 muaj edhe në ditë të plota. Kur për veprat penale është paraparë burgim pa theksuar masën më të vogël, kurse masa më e madhe nuk është më shumë se 3 vjet, përpos atij dënimi detyrimisht përcaktohet edhe dënimi me të holla. Dënimi vuhet në institucione për vuajtjen e dënimit të caktuar me ligj.⁷⁵ Shqiptimi i këtij dënimi është paraparë gjithherë edhe në mënyrë alternative me dënimin me burgimin e përjetshëm. Në disa raste në raport me dënimin me gjobë është paraparë në mënyrë alternative apo kumulative. Ndërsa, në raport me dënimet plotësuese, dënimi me burgim gjithherë është paraparë në mënyrë kumulative. Pra siç cekëm edhe më lart në bazë të Kodit Penal minimumi i përgjithshëm i burgimit është 30 ditë, ndërsa maksimumi i përgjithshëm është 20 vjet. Për veprat penale veç e veç, në legjislacionin penal më së shpeshti caktohet në mënyrëdecide minimumi dhe maksimumi i posaçëm i këtij lloji dënimi. Nëse minimumi i posaçëm nuk është caktuar, atëherë si kohëzgjatje më e shkurtër e dënimit me burgim konsiderohet minimumi i përgjithshëm (pesëmbëdhjetë ditë). Ndërsa, nëse

⁷⁴Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq119-121.

⁷⁵Kodi Penal i RM-së, 2015, fq 55.

nuk është caktuar maksimumi i posaçëm, atëherë si kufi më i lartë i kohëzgjatjes së dënimit me burgim konsiderohet maksimumi i përgjithshëm i këtij dënimi (njëzet vjet).⁷⁶

Ky lloj dënimi shqiptohet në vite dhe muaj të plotë. Ndërsa, nëse këtë lloj dënimi gjykata e shqipton në kohëzgjatje deri në gjashtë muaj, atëherë mund ta shqiptojë edhe në ditë të plota.

3.3 Rregullat minimale standard të OKB-së për trajtimin e të burgosurve

RegjistriNë çdo vend ku mbahen të burgosur duhet të mbahet një regjistër i lidhur dhe me numër faqesh ku për çdo të burgosur të shënohet: identiteti, arsyet e burgimit të tij dhe organi kompetent që ka vendosur për këtë, dita dhe ora e hyrjes dhe daljes. Asnjë person nuk duhet të hyjë në burg pa një vërtetim të rregullt ku të tregohet arsyeja e burgimit të tij, hollësitë e të cilit duhet të jenë parashtruar më parë në regjistër.⁷⁷**Ndarja e kategorive** nënkupton që burrat dhe grate duhet të mbahen sipas mundësive në godina të ndryshme: në një godinë ku mbahen burra edhe gra të gjitha lokalet që u shërbejnë grave duhet të jenë krejt të ndara. Të ndaluarit e paraburgosur duhet të jenë të ndarë nga të dënuarit. Personat e burgosur për borxhe ose të dënuar për të vuajtur një formë burgimi për çështje civile duhet të jenë të veçuar nga të burgosurit për çështje penale. Të burgosurit në moshë të re duhet të jenë të veçuar nga ata në moshë të rritur.⁷⁸**Lokalet e burgut** qelitë ose dhomat e caktuara për izolim gjatë natës nuk duhet të kenë më shumë se një të burgosur në rastet kur ka fjetore, këto duhet të strehojnë të dënuar të zgjedhur me kujdes dhe të njohur sitë përshtatshëm për t'i vendosur në kushte të tilla. Gjatë natës ata do t'i nënshtohen një mbikqyrje të rregullt, e cila duhet t'i përshtatet tipit të burgut. Lokalet e burgut dhe sidomos ato që janë të destinuar për strehimin e të burgosurve gjatë natës duhet t'u përgjigjen kërkesave të higjienës, të marrin parasysh klimën, në mënyrë të veçantë hapësirën e ajrosur, sipërfaqen minimale, ndriçimin, ngrohjen dhe ajrimin. **Higjiena personale**, të burgosurve duhet t'u kërkohej që mbajnë pastërtinë personale: për këtë atyre duhet t'u sigurohet ujë dhe artikujt e tualetit të nevojshëm për shëndetin dhe pastërtinë e tyre. Me qëllim që të burgosurit të mund të kenë një paraqitje të përshtatshme dhe të ruajnë respect për veten e tyre, duhet të sigurohen disa lehtësi për mirëmbajtjen e flokëve dhe të mjekrës, burrat duhet të kenë mundësi të ruhen rregullisht.⁷⁹

⁷⁶ Ismail Zejneli, E Drejra Penale pjesa e posaçme, Tetovë, fq 444.

⁷⁷ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 284.

⁷⁸ Po aty, fq 284.

⁷⁹ Po aty, fq 286.

Veshëmbathja dhe shtresat, çdo i burgosur që nuk është i autorizuar të mbajë veshjen e vetvetjake duhet të pajiset me një veshje që t'i përshtatet klimës dhe t'i mjaftojë për ta mbajtur atë në shëndet të mirë. Të gjithë veshjet duhet të jenë të pastra dhe në gjendje të mirë. Kur të burgosurit lejohen të mbajë veshjen e tyre vetjake duhet të merren masa, në çastin e hyrjes së tyre në institucion(burg), për të siguruar që veshja të jetë e pastër dhe e përdorshme.⁸⁰ **Ushqimi**, çdo i burgosur duhet të marrë nga administrata në orët e zakonshme në ushqim të cilësisë së mirë, të përgadituar dhe të shërbyer mirë dhe që të ketë një vlerë ushqimore të mjaftueshme për të ruajtur shëndetin dhe forcat. Çdo i burgosur duhet të ketë mundësi të siguroj ujë të pijshëm kurdoherë që ka nevojë. **Shërbimet mjekësore**, çdo institucion penitenciar duhet të ketë në dispozicion një mjek të kualifikuar, i cili të ketë njohuri në psikiatri. Do të ishte e udhës që shërbimet mjekësore të organizoheshin duke qenë në kontakt të ngushtë me administratën e përgjithshme të shërbimit shëndetësor të një rrethi ose të gjithë vendit. Për çdo të burgosur duhet parashikuar transferimin në institucione penitenciare të specializuara ose në spitale civile. Të burgosurit duhet të kenë mundësi të kurohet nga një dentist i kualifikuar.⁸¹ **Disiplina dhe dënimet**: rendi dhe disiplina duhet të mbahen me vendosmëri, por pa bërë kufizime me shumë se sa është e nevojshme për ruajtjen e sigurisë dhe të një jetë kolektive të organizuar mirë. Asnjë i burgosur nuk mund të ushtroj një pushtet disiplinor kur thirren të kryej ndonjë shërbim brenda institucionit. Pikat e mëposhme duhet të jenë gjithmonë të përcaktuara ose me ligj ose me një akt të autoritetit administrative kompetent:

- a) Sjellja që përbën një shkelje disiplinore
- b) Lloji dhe kohëzgjatja e masave disiplinore që mund të zbatohen
- c) Autoriteti kompetent për vendosjen e këtyre masave

Asnjë i burgosur nuk mund të dënohet veçse në përpushje me dispozitat e një ligji ose të një akti tjetër, por kurrë dy here për një shkelje. Asnjë i burgosur nuk mund të dënohet pa qenë në dijeni të shkeljes për të cilën akuzohet dhe pa patur mundësi të mbrohet. Autoriteti kompetent duhet të shqyrtojë rastin në tërësi. Dënimet trupore, mbyllje në qeli të errët si dhe çdo masë e egër,

⁸⁰ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 286.

⁸¹ Po aty, 287.

çnjerezore dhe degraduese duhet të jenë krejtësisht të ndaluara si sanksione disiplinore.⁸² **Mjetet shtrënguese**-,si hekurat, zinxhirët, këmishat e forces nuk duhet të përdoren kurrë si sanksione.

- a) Si masë sigurie për të shmangur arratisjen gjatë një transferimi, me kusht që ato(mjetet shtrënguese) të hiqen sapo i burgosuri del përpara një organi gjyqësor ose administrative:
- b) Për arsye mjekësore me porosi të mjekut
- c) Me urdhër të drejtorit, në qoftë se mjetet tjera për të mbajtur nën kontroll një të burgosur nuk kanë patur sukses, me qëllim që ai të mos mundi të dëmtoj veten e tij e të tjerët ose të shkaktojë dëme.

Informimi dhe e drejta e të burgosurve për tu ankuar-,çdo i burgosur kur hyn në burg duhet të ketë një informacion me shkrim mbi regjimin e të burgosurve të kategorise së tij, mbi rregullat disiplinore të institucionit, mbi mjete që janë të lejuara për t'u informuar dhe për të formuluar ankesa, si dhe mbi çdo pike tjetër që mund të jetë e nevojshme për t'i dhënë atij mundësinë të njohë të drejtat dhe detyrat dhe ti përshtaten jetës së institucionit. Nëse i burgosuri është analfabet ky informacion duhet t'i jepet atij gojarisht. I burgosuri duhet të ketë të drejtën, në çdo ditë pune, t'i parashtojë kërkesa dhe ankesa drejtorit të institucionit ose nënpunësit që është autorizuar ta përfaqësojë. I burgosuri duhet të lejohet pa censure në përmbajtje **porn ë** një formë të përshtatshme, një kërkesë ose ankesë administrates qëndrore të burgjeve, organit gjyqësor ose çdo organi tjetër competent, në rrugën që përcaktohet nga rregullat e burgut.⁸³ **Kontakti me botën e jashtme**,të burgosurit duhet të lejohen që nën mbikëqyrjen e nevojshme të komunikojë me familjen tyre si dhe me ata miq të tyre të cilëve mund t'u besohet në interval te rregullta, si me letërkëmbim ashtu edhe duke pritur vizita. Të burgosurve që janë shtetas të një shteti të huaj duhet t'u krijohen lehtësi të arsyeshme për të komunikuar me përfaqesuesit e tyre diplomatike e konsullore. Për sa u përket të burgosurve shtetas të shteteve që nuk kanë përfaqësues diplomatic ose konsullor në një vend, si dhe refugjatëve dhe personave pa shtetësi, duhet t'u krijohen edhe atyre po ato lehtësi për t'u drejtuar përfaqësuesit diplomatik të shtetit që mbikqyrë interes e tyre ose çdo autoriteti tjetër kombëtar apo ndërkombëtar që ka për detyrë t'i mbrojë. Të burgosurit duhet të mbahen rregullisht në dijeni të ngjarjeve më të rëndësishme, qoftë nëpërmjet leximit të

⁸² Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 288.

⁸³ Po aty, 289.

gazetave të përditshme, revistave ose të botimeve penitensiare ose çdo mjeti tjetër të ngjajshëm, të autorizuar ose të kontrolluar nga administrate. **Bibloteka**, çdo i burgosur duhet të ketë një bibliotekë të hapur për të gjitha kategoritë e të burgosurve dhe mjaft të pasur me libra instruktiv dhe çlodhës. Të gjithë të burgosurit duhet të nxiten ta përdorin bibliotekën sa më shumë.⁸⁴ **Inspektimi**, inspektorët të kualifikuar dhe më përvojë, të caktuar nga një organ kompetent, duhet të kryejnë inspektime të rregullta në burgje dhe shërbimet në to. Ata duhet të kujdesen në mënyrë të veçantë që këto institucione të administrohen në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi dhe me qëllim që të arrihen objektivat e shërbimeve penitensiare dhe korrektuese.⁸⁵

Kam pasur rastin që më datë 10 Maj 2018, nën udhëheqjen e ligjerueses Prof.Dr.Besa Arifi bashkë me koleget e mi të vizitojmë Entin Ndëshkues Korrektues në Idrizovë Shkup. Ne patëm mundësi që të shohim nga afër kushtet, organizimin dhe hapësirat e gardianët të cilët gjatë gjithë kohës na dhanë sqarimet të cilat na interesonin. Nga ajo që pamë vërejtëm që të burgosurit ishin të ndarë sipas moshës, gjinisë dhe rasteve të kryerjes së veprës penale dhe vuajtjes së dënimit. Në prani të gardianëve na u dha mundësia që t'i vizitojmë edhe qelitë ato të izoluara dhe kolektive. Me të vertetë kushtet ishin të mjerueshme. Pikë së parë do të cekim kushtet higjienike ku qelive u mungonin kushtet themelore si uji dhe artikujt e tualetit. Gardianët theksuan që të dënuarit kanë të drejtën e punës dhe angazhimit në procesin e punës për të cilin ai do të shpërblehet. Të burgosurit kishin të drejtën për pranimin e vizitave kjo që është një e drejtë themelore që ato t'i vizitojnë antarët e ngushtë të familjes. Edhe të dënuarit të cilët vuanin dënimin në këtë ent kishin të drejtën e pranimin të pakove dhe letrave. Në këtë Ent poashtu patëm mundësinë të vizitojmë edhe repartin e posaçëm në të cilin e vuajnë dënimin të dënuarat femra numri i të cilave ishte shumë më i vogël se ai meshkujve. Sa u përket kushteve higjienike në këtë repart ishin shumë më të mira, pastërtia ishte në një nivel më të lartë se ai i repartit të meshkujve. Poashtu, ajo çka më ra në sy në këtë repart ishte se kishte bibliotekë të hapur e cila ishte e pasur me libra. Mendoj që kushtet e Entit Ndëshkues Korrektues të Idrizovës ishin paka shumë të përputhshme me rregullat minimale standard të OKB-së për trajtimin e të burgosurve përveç kushteve të mjerueshme higjienike të qelive pa ujë dhe artikujt të tualetit.

⁸⁴ Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, fq 290.

⁸⁵ Po aty, 293.

KAPITULLI I IV

4.1 Analiza dhe krahasimi nga materialet statistikore

Nga rezultatet e marra në Gjykatën Themelore të Gostivarit gjatë periudhës kohore 2010-2018 në tabelën në vijim do të vërehet numrin e veprave penale të rënda. Nga statistikatat e marra në Gjykatë vërehet se më të regjistruarat në qytetin tonë si vrasje të rënda janë: vrasjet në mënyrë mizore, vrasjet me qëllim të fitimit të dobisë pasurore, vrasjet nga hakmarrja.




Tabela numër 1.

Siç shihet qartë në tabelën numër 1 vërehet që gjatë vitit 2010 janë regjistruar **8** vrasje të rënda penale ku nga këto vrasje janë regjistruar **2** viktimë me pasoja vdekjeje. Gjatë vitit 2011 janë regjistruar **12** vrasje penale të rënda në Gjykatën e Gostivarit nga të cilat kemi **1** viktimë me pasoja vdekjeje. Në vitin 2012 poashtu janë regjistruar **12** vrasje të rënda nga të cilat janë regjistruar **3** viktimë. Pra, gjatë vitit **2011-2012** vërehet që janë regjistruar më së shumti vrasje të rënda penale. Në vitin 2013 vërehet që kemi ulje të regjistrimit të vrasjeve të rënda pra janë

regjistruar **6**, nga të cilat është paraqitur **1** viktimë. Përsëri nga ku vit vërejmë rritjen e vrasjeve të rënda ku gjatë vitit 2014 janë regjistruar **9** vrasje nga të cilat janë paraqitur **2** viktima me pasoja vdekje. Gjatë vitit 2015 janë regjistruar **11** vrasje të rënda nga të cilat kemi pasur **2** viktima. 2016 janë regjistruar **6** vrasje dhe poashtu kemi pasur **2** viktima me pasoja vdekje. Gjatë vitit 2017 janë regjistruar **11** vrasje të rënda nga të cilat kemi pasur **4** viktima dhe vitin 2018 janë regjistruar **7** vepra penale të rënda ku poashtu kemi pasur **4** viktima me pasoja vdekje. Kjo tregon që gjatë dy viteve të fundit kemi rritje në numrin e viktimave me pasoja vdekjesh në qytetin tonë! Në bazë të këtyre statistikave të marra nga Gjykata Themelore e Gostivarit, në lidhje me vrasjet e kualifikuara do të mundohem detajisht si sqarojë se si mundet të parandalojmë në kryerjen e veprat penale të rënda në qytetin tonë. Nga analiza ematerialit të grumbulluar mund tëkonstatojmëse faktorët kryesor që shkaktojnë këtë fenomen janë faktoret socio-ekonomik, siç mund të jenë urrejtjet ndëretnike, barazia gjinore, mosvleresimi i barazisë gjinore, mosmarreveshjet pronësore, dhuna në familje dhe krizat e ndryshme financiare brenda rrethit familjar. Sipas mendimit tim personal për parandalimin e këtij fenomeni do të ishte e nevojshme të ndërmeren masa të ndryshme shoqërore, si: kampanja sensibilizimi në lidhje me çështjen e bashkëjetesës ndëretnike dhe poashtu me iniciativa të ndryshme të konkretizohet çështja e barazisë gjinore. Siç përmendëm më lart, kriza ekonomike, jostabiliteti i plotitkës së brendshme konsiderohen si faktore kryesor në paraqitjen e këtij fenomeni, në këtë drejtim duhet të ndërmeren masa reformuese dhe parandaluese në mënyrë që rritja dhe progresi ekonomik të vërehen në të gjitha sferat dhe shkallët e shoqërisë tonë me qëllim që të kemi ulje të kriminalitetit. Poashtu në veçanti duhet theksuar që emancipimi dhe civilizimi i popullatës ndikon në rënien e këtij fenomeni. Analiza krahasore e këtyre të dhënave mund të vërehet qart se gjatë çdo viti vrasjet e kualifikuara, pra vrasjet e rënda të cilat nënkuptojnë privimin e tjetrit nga jeta me paramendim janë prezente në qytetin tonë, kjo që na bën të ndjehemi të pasigurt herë pas here. Një fenomen i rrezikshëm si ky, që rrethon qytetin tonë shton ankthin te qytetarët çdo ditë e më shumë .

Në tabelën në vijim na paraqitet numri i viktimave me pasoja vdekje të regjistruar nga vrasjet rënda penale⁸⁶

Viti i kryerjes	Numri i viktimave me pasoja vdekje	Gjithësej
2010	2	
2011	1	
2012	3	
2013	1	
2014	2	
2015	2	
2016	2	
2017	4	
2018	4	
		21

Gjatë vitit 2010-2016 kemi numër pothuajse të ngjajshëm të paraqitjes së viktimave me pasoja vdekje pra në vitin 2010-**2**, 2011-**1**, 2012-**3**, 2014-**2**, 2015-**2**, 2016-**2** mirëpo gjatë vitit 2017 dhe 2018 kemi rritje të këtyre viktimave.

Gjatë dy viteve të fundit janë regjistruar nga **4** viktima me pasoja vdekje kjo tregon që kemi rritjen e viktimave nga veprat penale të rënda. Meqë në titujt e lartëpërmedur kemi folur për faktoret objektiv dhe subjektiv që ndikojnë në paraqitjen e këtij fenomeni, mendoj që një nga shkaqet apo faktori kryesorë se pse nga viti 2010 e deri në 2018 kemi rritje të këtyre veprave është varfëria, pra kriza ekonomike e cila vërehet qartë edhe në qytetin tonë ku mund të konsiderohet si një shkak që ndikon në rritjen e vrasjeve, vjedhjeve, dhe veprave penale të rënda. Papunësia e cila shtohet çdo ditë e më shumë i shtyen njerëzit në rrugë pa kthim, në rrugët e rrezikshme të cilat mund të përfundojnë edhe në burgim të përjetshëm. Gjendja e rëndë sociale dhe ekonomike në vend edhe më tej e rëndon jetën e bashkëshortore dhe fëmijëve të tyre çdo ditë e më shumë. Konfliktet mes parterëve lidhja e të cilëve mund të shkoj edhe drejt divorcit poashtu mund të konsiderohet si një faktor konkret në regjistrimin e veprave penale të kualifikuara. Domethënë, si shkak i rritjes së numrit të vrasjeve të rënda mendoj që është kriza ekonomike, pra ndikimi i varfërisë, papunësisë, kushtet e vështira të banimit në qytetin tonë që çdo ditë e më shumë bëhen edhe më të rënda dhe të papërballueshme.

⁸⁶ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Gostivarit


Në tabelën e radhës sipas të dhënave që nxorëm nga arhiva e Gjykatës Themlore të Gostivarit për veprat penale kundër jetës dhe trupit me dënim me burgim gjatë viteve 2010-2018 do të paraqesim të dhënat e shfrytëzuara si lloji i veprës dhe numri i dënimit me burgim ⁸⁷.

Numri i lëndës	Bazë shkresë juridike	Vendim	Shkresë vendimi
K-292/10	Vrasje e rëndë (kualifikuar)	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-318/10	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
K-210/11	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-434/12	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-504/12	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-91/12	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-597/13	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-157/14	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-96/14	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-181/15	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-427/15	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-147/16	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-148/16	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-181/17	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-234/17	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-28/17	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-288/17	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit

⁸⁷ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Gostivarit

k-142/18	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-156/18	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-472/18	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit
k-522/18	Vrasje e rëndë	Dënim me burg	Vepra penale kundër jetës dhe trupit

Në tabelën nr 3 do të paraqesim viktimat e paraqitur nga veprat penale të rënda sipas gjinisë⁸⁸



Gjinia është njohur si një nga faktorët më të rëndësishëm që luan një rol të rëndësishëm në trajtimin e llojeve të ndryshme të krimeve brenda sistemeve të drejtës penale. Nga të dhënat e marra në Gjykatë edhe se nuk kemi numrin konkret të gjinisë të cilët i kanë kryer këto vepra

⁸⁸ Të dhëna nga arkivi i Gjykatës Themelore të Gostivarit

penale mendoj që gjinia mashkullore dominon në kryerjen e veprave penale të rënda në qytetin e Gostivarit. Ekziston një përshtypje e përgjithshme, në bazë të të dhënave të statistikës kriminale dhe praktikës gjyqësore, se kriminaliteti është një dukuri tipike e gjinisë mashkullore, kjo që vërehet në mënyrë absolute edhe në qytetin tonë gjatë periudhës 2010-2018. Ku p.sh në vitin 2010 janë regjistruar 8 vepra penale të rënda nga të cilat 7 janë kryer nga ana e gjinisë mashkullore dhe 1 nga ana e gjinisë femërore. Sa i përket pjesëmarrjes së femrave në kriminalitet mund të thuhet se ato më tepër marrin pjesë në kryerjen e krimeve ndihmëse, kryerëse të drejtpërdrejta apo organizatore të krimeve të caktuara. Nga viti 2010 e deri në vitin 2018 nga rezultatet e marra vërejmë se si viktimat me pasoja vdekjeje janë paraqitur **17** persona të gjinisë mashkullore, pra **85%** ndërsa **4** viktimat të gjinisë femërore **15%**.

4.2 Lënda e marrë nga gjykata themelore e Gostivarit

Në vijim do të paraqesim aktgjykimin e marrë nga Gjykata Themelore e Gostivari

NË EMËR TË QYTETARËVE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT!

GJYKATA THEMELORE E GOSTIVARIT –

Si gjykatë penale e shkallës së parë, në Trupin gjykues të përbërë nga gjykatësi D.V- kryetar i trupit gjykues, nga gjykatësja M.M dhe nga gjyqtarët porotnik S.J dhe M.S si anëtarë të trupit gjykues në mbajtjen e procesverbalit 12.03.2018 kundër të pandehurit **B.G.** Gjatë zhvillimit të procedurës penale kundër të pandehurit **B.G** i lindur më 02.11.1979 në Shkup i akuzuar në bazë të nenit 123 paragrafi 1 me propozim akuzë P.nr 393/17 të datës 24.09.2018 në prani të prokurorit publik XH.H, të pandehurit dhe avokatit të tij të caktuar kryesisht L.V nga Shkupi nxori dhe shpalli publikisht këtë :

AKTGJYKIM

I PANDEHURI: B.G i lindur më 02.11.1979 në Shkup, me arsim të mesëm, puntor privat, i cili jetoi në një komitet jashtë martesor për 7 vite.

ËSHTE FAJTOR

PËR ARSYE SE:

Më 17.09.2017 rreth orës 09.00 në Gostivar në lagjen Ivo Lola Ribar nr.134 për shkak të mardhënieve tëshqetësuarra martesore me të ndjerën S.R e ka privuar nga jeta në mënyrë tinzare (dinake) në mënyrë që i pandehuri fillimisht parkoi veturën e tij, ka pritur që e ndjera të dal në rrugë, në atë moment që ajo shfaqet para shtëpisë së saj i pandehuri del nga makina i cili me në sjellje mashtruese apo të fshehtë është drejtuar të ndjerës me këto fjalë “Çfarë është moj zonjë, a nuk më shikon.

E ndjera kur e ka parë të pandehurin ka filluar të bërtas ndihmë do të më vrasë, i pandehuri i ka thënë qetësohu dua të kthehesh në shtëpi te fëmijet tu bëhesh nënë atyre. Në atë moment i pandehuri nxjer thikën me të cilën e ka goditur disa herë të ndjerën, ku e ndjera pushon. I pandehuri largohet menjëherë nga vend ngjarja.

AKUZAT BAZUAR NË PROVAT E MËPOSHME:

- Regjistrimi i shtëpisë 5 katëshe dhe hapsirave tjera nr.28.11.1-23 nga 17.09.2017 në MPB Shkup
- Vërtetimi i dëshmitarëve
- Mbështetje për objektet e sekuestruara përkohësisht nr.28.11.1-103/1 nga 19.09.2017 MPB Shkup me thikë kuzhine 20 cm.
- Vërtetim i sendeve të sekuestruara përkohësisht
- Procesverbali për një ekzaminim ekzekutiv të një personi, mjetit të transportit ose bagazhit në Çair -Shkup
- Raporti i ekspertizës me regj.nr. 23.5.2.2- 69164/1 prej 27.10.2017 nga departamenti i kriminalistikës dhe mjekimit ligjor.

E ndjera para disa muajsh ka ikur me dy fëmijët e saj në Veles tek ish- bashkëshorti prandaj edhe i pandehuri e ka denoncuar në polici duke menduar se është humbur. Pas një kohe i pandehuri e kupton ku ka qenë e ndjera. Gjatë obduksionit për analizat është marrë gjak, për

qëllim të përcaktimit të grupit të gjakut të së ndjerës S.R për të vërtetuar praninë e mundshme të alkoholit apo medikamenteve të ndryshme.

E DËNON: Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 20 vitesh në të cilën dënim i llogaritet edhe koha të cilën do ta kaloj i pandehuri në paraburgim.

TE PAGUAJ: I pandehuri në emër të paushallit penal duhet të paguaj shumën prej 5.000,00 den.

Është i detyruar t'i mbulojë edhe shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 117.173,00 den.

GJYKIMI I PARË

ARSYETIM: Prokuroria Themelore Publike në Gostivar e ka akuzuar të pandehurin me vepër penale VRASJE nga neni 123 paragrafi 1 i KP. Gjykata pasi e shqyrtoi këtë akt, caktoi dhe mbajti seancën kryesore më 13.03.2018 ku Gjykata shpalli fajtor të pandehurin **B.G** për arsye se e privoi nga jeta S.S më datë 17.09.17 në Gostivar. I akuzuari dënohet me 20 vjet burgim. Masa që i pandehuri e kaloi në paraburgim dhe koha që e kaloi në paraburgim do të llogariten në dënimin me burgim në pajtim me nenin 47 të K.P

I pandehuri është i detyruar të paguaj shumën prej 5.000,00 den.

Masën e paraburgimit do ta vuaj; në Shkup.

GJYKIMI I DYTË

Gjykata e Apelit – në Trupin gjykues të përbërë nga gjykatësi SH.H- kryetar i trupit gjykues, nga gjykatësja M.M dhe nga gjyqtarët porotnik S.J dhe M.S si anëtarë të trupit gjykues në mbajtjen e procesverbalit më 21.05.2019 ligji për procedurën penale miratoi publikisht këtë **AKTGYKIM**

ANKESA e të pandehurit **B.G**, e paraqitur përmes avokatit të tij L.V është refuzuar si e **PABAZUAR**.

ARSYETIM- Gjykata Themelore Gostivar, me aktgjykimin e apeluar nr.156/18 nga 24.09.18 të pandehurin **B.G** e shpalli fajtor për vepër penale të **VRASJES** neni 123 ku gjykata e dënoi me 20 vjet burg. Masën e paraburgimit do ta vuajë në Shkup.

I pakënaqur **B.G** paraqiti apel në kohë nëpërmjet avokatit të tij me një propozim që gjykata e apelit ta mbështesë **ANKESËN** e të pandehurit ku ka kërkuar t'i shqiptohet sanksion më i butë e cila do të jetë më adekuate sipas ashpërsisë së veprës penale.

Avokati L.V kërkoj që të pandehurit t'i shqiptohet masë më e butë, meqë i pandehuri ka qenë korrekt në gjithë rrjedhjen e procedurës penale, pranoi se ka kryer vepër të rëndë penale i cili shpreh keqardhje për atë që ka bërë dhe kontriboi që procedura të përmbyllet shpejt. Poashtu, gjykata duhet të ketë parasysh se i pandehuri ka 3 fëmij që dikush duhet të miret me to.

Pra, gjykata duhet ta ketë parasysh që kundër të pandehurit nuk ndiqet procedurë tjetër.

ANKESA ËSHTË E PABAZUAR

Pra, gjykata e shkallës së parë kur vendosi për llojin e sanksionit penale vlersoi të gjitha vlerat nga neni 39 i K.P duke pasur parasysh të gjithë rethanat që ndikojnë që sanksioni të jetë më i ulët apo më i lartë, rrethana lehtësuese apo rënduese, mirëpo ka pasur parasysh në veçanti që fakti se është kryer vepër e rëndë (kualifikuar) penale ka vendosur që gjykata ka dhënë vendimin e duhur. Pra, si formë më e shpeshtë e kriminalitetit të dhunës paraqiten krimet ndaj jetës dhe trupit të cilat cilësohen si forma më të rënda të atakimit të vlerave dhe të mirave më të shtrenjta të njeriut siç është jeta. Aplikimi i metodës praktike në këtë punim masteri gjegjësisht elaborimi i një studim rasti i cili fatkeqsisht ka ndodhur në teritorin e komunës së Gostivarit për nga kualifikimi juridik kemi të bëjmë me vepër penale vrasje në mënyrë mizore apo tinzare e paraparë në nenin 123 paragrafi 2 pika 1 e Kodit Penal të Republikës e Maqedonisë së Veriut. Për nga natyra juridike kjo vepër penale paraqitet si vrasje e kualifikuar me ç'rast si pasoj e veprimit kriminal të ndërmar nga i pandehuri edhe dënimi për kesi lloj veprash penale është minimum 10 vjet burgim dhe më lart. Sa i përket aktgjykimit të caktuar në punimin e masterit në vijim e jap këtë mendim: Gjykata Themelore në Gostivar pas shqyrtimit të gjithë provave të propozuara në aktakuzën e prokurorit publik e ka vërtetuar gjendjen faktike në tërësi ku si fakte të provuara paraqiten dëshmitarët, mjeti me të cilën është kryer vepra penale (thikë kuzhine 20 cm), procesverbal për ekzaminimin ekzekutiv të një personi mjetit të transportit apo bagazhit si dhe

raporti i ekspertizës mjekoligjore. Ajo çka këtë rast e bën të kualifikuar dhe i jep formë më të rëndë të vrasjes (vrasja në mënyrë tinzare) paraqiten rrethanat të cilat i pandehuri me qëllim që viktimë të mos bëjë rezistenc fizike ka tentuar me fjalë të buta që ta qetësojë viktimën me qëllim që viktimë të krijoj një besim të rejshëm e më pas ta kryej likuidimin fizik të viktimës. Pra, elementi subjektiv i kryerësit të veprës penale në veprën penale vrasje në mënyrë tinzare përfshin elementin intelektual që nënkupton vetëdijen e kryerësit që është duke kryer vepër të rëndë penale si dhe aftësinë e tij në aspekt të kontrollimit të veprimeve të veta që nënkupton plotësisht i aftë mendërisht (duke përjashtuar rrethanat e papërgjeshmërisë dhe papërgjegjshmërisë esenciale të zvogëluar si dhe rrethanat e *actio liberae* i cusa- përdorimin e substancave që ndikojnë në uljen e elementit intelektual) si dhe elementi volutiv apo dashja me çrast në këtë vepër penale paraqitet si vepër penale vrasje me paramendim. Për mendimin tim kjo ka qenë fakti kryesor që ka ndikuar që Gjykata gjatë vërtetimit të gjendjes faktive ta kualifikoj vrasjen si vrasje të rëndë. Vlen të theksohet që në veprat penale në përgjithsi dhe në veçanti për vrasjet aspekti subjektiv i kryerësit qëllimi dhe motivi janë esenciale për ashpërsimin apo zbutjen e dënimit pasi nëpërmjet qëllimit apo motivit kryerësi i veprës i hedh dritë personalitetit të tij kriminal dhe në këtë rast Gjykata për ta kompletuar figurën e veprës penale është e detyruar që ta qartësojë elementin subjektiv-psiqik të kryerësit. Edhe raporti me viktimën luan rol të veçantë në kualifikimin e veprës penale si dhe shqiptimin e dënimit me çka në rastin konkret i pandehuri ka privuar nga jeta bashkëshorten e vet si pasojë e marrëdhënieve të shqetësuara martesore me çka kjo e rëndon pozitën juridike të pandehurit. Sa i përket lidhjes kauzale midis kryerësit dhe veprës në mënyrë të pakontestuar është vërtetuar fakti që i pandehuri është kryerës i veprës penale të kryer në mënyrë tinzare kjo si pasojë e vërtetimit të fakteve si pyetja e dëshmitarëve okular, gjetja e mjetit me të cilën është kryer vepra penale, kjo si pasojë e ekspertizës mjekoligjore dhe shenjave biologjike me çka janë prova të pakontestueshme të cilat e vërtetojnë fajsinë e të pandehurit. Sa i përket shqiptimit të dënimit me burg në kohëzgjatje prej 20 vitesh Gjykata ka vendosur ta zëvendësojë burgun e përjetshëm me minimum 20 vjet burgim me çka këtë mundësi e ofron Kodi Penal në varsi të rrethanave dhe natyrës kriminale të veprës. Theksojmë që qëllimi i dënimit është preventiva speciale që nënkupton risocializimin dhe riedukimin e të pandehurit që ai në të ardhmen të bëhet i dobishëm për shoqërinë si dhe preventiva gjenerale që nënkupton që kryerësit potencial të veprave të atilla të distancohet nga veprimet e atilla që do t'i penalizonte për tërë jetën. Mendoj që Gjykata ka shqiptuar dënim meritore për të pandehurin duke pasur parasysh faktin që kjo vepër penale është

vrasje e kualifikuar dhe si e tillë për nga natyra juridike edhe dënimi është shumë më i rëndë për dallim nga vrasjet e rëndomta.

PËRFUNDIM

Përmes këtij punimi mundova të jap një pasqyrim lidhur me veprat penale të kualifikuara të kryera në qytetin e Gostivarit, duke u bazuar në të dhënat statistikore të marra në Gjykatën Themelore të Gostivarit vërehet qartë se ky fenomen paraqet rrezikshmëri në qytetin tonë. Një çështje mjaft e rëndësishme si kjo, kohëve të fundit zgjerohet në mënyrë rapide, kjo që shton ankthin te qytetarët dhe i bën ato të ndjehen të pasigurt. Çdo person mund të viktimizohet në çdo moment, andaj ne si shoqëri duhet të jemi të gatshëm që ta luftojmë këtë fenomen. Ne duhet të luftojmë këtë fenomen me qëllim që të jetojmë në harmoni e jo nën presion. Pra, në bazë të statistikave të lartëpërmendura mund të vijmë në konkluzion që ky lloj fenomeni tregon rritje të viktimave gjatë 2 viteve të fundit. Këto janë fakte shqetëuese dhe të rrezikshme që përhapen në qytetin tonë. Sai përket mendimit tim personal mendoj që fillimisht është detyra e institucioneve shtetërore të marrin masa për parandalimin e këtyre veprave të rënda penale. Meqë përmendëm papunësinë dhe varfërin si një nga faktorët kryesor në rritjen e këtyre veprave penale, fillimisht institucionet shtetërore duhet të marrin iniciativë për hapjen e konkurseve të reja pune me qëllim që të zgjidhet kjo krizë ekonomike dhe atëherë mendoj që nuk do t'i kemi po të njejtat statistika. Poashtu, institucionet duhet të inkurajojnë në denoncimin e paraqitjes së veprave penale, që të ndërmirën masa në kohë të duhur. Nëse ne si shoqëri mundohemi sado pak të marrim masa të përbashkëta për parandalimin e këtij fenomeni si p.sh (hapi i parë duhet të jetë të paraqesim viktimizimin tonë në polici qoft edhe një ngacmim i vogël, çdo lloj abuzimi) me qëllim që të realizojmë një veprim kolektiv ku do të mundohemi ta sulmojmë këtë fenomen të rrezikshëm që na rrethon.

Përgjatë vështimit dhe analizimit të statistikave të marra në Gjykatën Themelore të Gostivarit vërejtëm që nga viti **2010-2018** janë regjistruar plot **82** vepra të rënda penale nga të cilat kemi **21** viktima me pasoja vdekje. Mendoj që është një numër shqetësues i veprave penale për sa i përket qytetit tim dhe duhet të marrim masat e nevojshme për uljen e kriminalitetit që të mund të jetojmë më të qetë dhe në harmoni. Nga analiza e materialit të grumbulluar mund

tëkonstatojmëse faktorët kryesor që shkaktojnë këtë fenomen janë faktoret socio-ekonomik, siç mund të jenë urrejtjet ndëretnike, barazia gjinore, mosvlerësimi i barazisë gjinore, mosmarreveshjet pronësore, dhuna në familje dhe krizat e ndryshme financiare brenda rrethit familjar. Sipas mendimit tim personal për parandalimin e këtij fenomeni do të ishte e nevojshme të ndërmeren masa të ndryshme shoqërore, si: kampanja sensibilizimi në lidhje me çështjen e bashkëjetesës ndëretnike dhe poashtu me iniciativa të ndryshme të konkretizohet çështja e barazisë gjinore. Pra, vrasjet e rënda penale duke qenë një fenomen mjaft kompleks, parandalimi i këtij fenomeni mund të bëhet edhe në mënyrë personale edhe në mënyrë të përgjithshme nga ana e shoqërisë duke bërëdenoncimin e paraqitjes së veprave penale, me qëllim që njerëzit të bëhen më të vetëdijshëm se si t'i shmangin këto veprime kriminale me qëllim që të ndërmiren masa në kohë të duhur. Pra ne si shoqëri dhe bashkëqytetar duhet realizuar një punë kolektive duhet sulmuar problemin direkt nga rrënjët të cilin mund ta arrijmë nëpërmjet kampanjave të sensibilizimi në lidhje me çështjen e bashkëjetesës ndëretnike dhe poashtu me iniciativa të ndryshme të konkretizohet çështja e barazisë gjinore.

LITERATURA

I- LIBRA

- Vllado.K&Ismail.Z, E drejta penale pjeas e pergjithshme, Tetovë, 2018
- Vlado Kambovski, E Drejta Penale pjesa e pergjithshme, Shkup, 2010
- Franjo Bacic, E drejta penale pjesa e pergjithshme, Shkup, 1972
- Ismet Salihu, E Drejta Penale pjesa e pergjithshme, Prishtinë, 2012
- Ismail Zejneli, E Drejta Penale pjesa e posaçme, Tetovë, 2007
- Ismail Zejneli, Delikuenca e të miturve, Tetovë/Prishtinë, 2018
- Ismet Elezi, E drejta penale pjesa e posaçme, Tiranë, 2003
- Ragip Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2011
- Ragip Halili, Penologjia, Prishtinë, 2010
- Ejup Sahiti & Ismail Zejneli, E Drejta e procedurës penale, Shkup, 2017
- Vesel Latifi, Politika kriminale, Prishtinë, 2008
- Grup autorësh E drejta penale Evropiane (përkthim), Tiranë, 2009

II- BURIME TJERA

- Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë
- Ligji i procedurës penale të R.M
- Kodi penal i Kosovës
- Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve, në RMV
- Vendime gjyqësore,

BURIME NGA INTERNETI

<http://economics.fundamentalfinance.com/povertycrime.php>

<https://telegrafi.com/papunesia-ne-maqedoni-ka-shenuar-renie-te-lehte/>

<http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=9>

<https://onlinelibrary.wiley.com/doi/pdf/10.1002/9781118519639.wbecpx275>

<https://www.lawteacher.net/free-law-essays/criminology/relations-between-gender-and-crime.php>

<http://www.stat.gov.mk/PrikaziPoslednaPublikacija.aspx?id=43>

https://sq.wikipedia.org/wiki/Demografia_e_Maqedonisë_së_Veriut